

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5521
E hënë, 9 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Veseli: Nga sot fillon Dekada e Re për PDK-në dhe Kosovën

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, në Konventën e Gjashtë Zgjedhore të Rinisë Demokratike, ku kryetar i ri është zgjedhur Donjet Bislimi, ka thënë se nga sot fillon Dekada e Re për PDK-në dhe Kosovën ■ FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

A KA NJË VEND TJETËR AFËR ITALISË, KU FJALA PAQE MUND TË TINGËLLOJË MË FORT SE KOSOVA?

F. 10



Behgjet PACOLLI

PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (4)

F. 11



Hajdin ABAZI

ERDHËN PËR PUSHIME NË VENDLINDJE, HUMBËN JETËN NË AKSIDENT TRAFIKU

F. 7

EKONOMI

KURTI: 10 PËR QIND E FAMILJEVE NË KOSOVË PAGUAJNË RYSHFET

F. 8

LEKAJ: TUNELI I 'ALPEVE SHQIPTARE' E SHKURTON RRUGËN PËR NË MAL TË ZI RRETH 45 MINUTA

F. 9

KULTURË

QYTETI I FLIJIMIT PËR LIRI

F. 13

Mr. sc. Fatmir HALIMI

SPORT

REXHA FITOI TITULLIN DHE KUPËN, POR NUK LUAJTI NË EVROPË

F. 14

FLET PËR "EPOKËN E RE", DARDAN GASHI ■ FAQE 4-5

Diaspora duhet të bëhet pjesë e sistemit politik

Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka thënë se të gjitha kërkesat e diasporës janë duke u marrë parasysh nga institucionet e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se diaspora duhet të bëhet pjesë e sistemit politik të Kosovës. Gashi ka treguar se është duke diskutuar me partitë politike që kërkesat e diasporës, si vendet e rezervuara në Kuvendin e Kosovës, themelimi i një televizioni për diasporën, kërkesa për kartonin e gjelbër, mësimi plotësues në gjuhën shqipe dhe kërkesa të tjera të bëhen realitet. Ai ka bërë me dije se partitë politike kanë mendime të ndryshme për përfaqësimin politik të diasporës në institucionet e Kosovës. "Një prej këtyre mendimeve është që diaspora t'i ketë në Kuvendin e Kosovës 5 deri në 6 vende të rezervuara", ka thënë Gashi



Koalicioni qeverisës e mbështet Thaçin për udhëheqës të dialogut

Presidenti Hashim Thaçi ka marrë mbështetjen e koalicionit qeverisës për ta drejtuar procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Përfaqësuesit e subjekteve që janë pjesë e këtij koalicioni kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se Kushtetuta i jep legjitimitet presidentit Thaçit për ta përfaqësuar Kosovën në dialog. Megjithatë, sipas tyre, është më se e nevojshme që për këtë proces të dialogut të arrihet konsensus politik ■ FAQE 3



Më pak se një për qind e qytetarëve kanë sigurime jetësore

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se më pak se një për qind e qytetarëve të Kosovës kanë sigurime jetësore. Sipas tij, qytetarët e

Kosovës shpenzojnë vetëm 44 euro në vit për sigurime, që përbën vlerën më të ulët në rajon. Mazreku ka theksuar se industria e sigurimeve përballet me mjaft sfida, duke filluar nga legjislacioni tatimor ■ FAQE 8-9



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Pritren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiqi: Nuk kam propozim për Kosovën

BEOGRAD, 8 KORRIK - Presidenti serb, Aleksandar Vuçiqi, tha se aktualisht nuk ka asnjë propozim për një zgjidhje të përhershme të problemit të Kosovës. Ai vuri në dukje se do të shkonte te njerëzit kur të kishte diçka për ta ofruar. "Çfarëdo që bëjmë, duhet të shkojmë në referendum. Çfarëdo që ndryshojmë

dhe në çfarëdo mënyre, çfarëdo ndryshim kushtetues që duhet të bëjmë, duhet të shkojmë në një referendum", tha Vuçiqi për mediet në Zemun.

Vuçiq itha se po përpiqet çdo ditë për të fituar diçka më të mirë dhe më shumë se ç'ishte më parë. "Në nivelin ditor, po përpiqemi të mbajmë diçka dhe të

kemi diçka nga Kosova. Gjithkush që më kritikon çdo ditë e di se sa kam të drejtë", tha Vuçiqi dhe u kërkoi kundërshtarëve politikë që të mos e gënjejnë veten, as atë dhe as popullin për zgjidhjen e mundshme për Kosovën. Ai tha se nuk i bie ndërmend të thërrasë një referendum nëse nuk ka asgjë

më të rëndësishme se ajo që kanë sot. "Do të jetë shumë e vështirë rreth Kosovës. Më mirë është të arrihet një marrëveshje sesa mos të arrihet", tha ai.

I pyetur për tërheqjen e serbëve nga Forca e Sigurisë së Kosovës, për të cilat zyrtarët e Prishtinës pretendojnë të jenë nën presion nga Beogradi, Vuçiqi tha se qën-



drimi i tij ishte se serbët nuk duhet të marrin pjesë në punën e tyre.

Thaçi: Kemi nevojë për marrëveshje përfundimtare me Serbinë

"Si Kosova, ashtu edhe Serbia, duan të jenë pjesë e Bashkimit Evropian dhe të dy shtetet e dimë se duhet ta njohim njëri-tjetrin. BE-ja nuk do të na pranojë me probleme. Ne kemi nevojë për një marrëveshje ligjërish të detyrueshme. E di se do të jetë jashtëzakonisht e vështirë për të dyja palët, sidomos për Kosovën", ka thënë Thaçi

PRISHTINË, 8 KORRIK - Revista më e vjetër diplomatike në Holandë, "Diplomat", ballinën e numrit të saj më të ri ia ka kushtuar presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Kjo magazinë diplomatike ka shkruar për mesazhet diplomatike të presidentit Thaçi të dhëna në Institutin holandez për Marrëdhënie Ndërkombëtare "Clingendael". "Paqja dhe drejtësia janë dy çështje themelore për çdo shoqëri, veçanërisht për ato në tranzicion", citohet të ketë thënë Thaçi, shkruan "Diplomat".

Revista e parë diplomatike holandeze ka shkruar se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka prodhuar një marrëveshje historike në Bruksel, saktësisht pesë vjet më parë. "Ne jemi krenarë me luftën tonë për liri dhe nuk kemi asgjë për të fshehur apo për t'u frikësuar nga e vërteta. Askush asnjëherë nuk u përpoq të ikte apo të fshihej nga drejtësia, krahasuar me shtetet e tjera në rajon", citohet të ketë thënë Thaçi.

Duke folur për shtetndërtimin në Kosovë, presidenti Thaçi ka theksuar se vetëm dhjetë vjet

më parë Kosova shpalli Republikën më të re në Evropë dhe tani mund t'i shikojmë me krenari arritjet gjatë dekadës së kaluar. "Kosova është një rrëfim suksesi, por kemi ende sfida të shumta, ashtu siç kanë edhe të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor", ka thënë ai.

Sipas revistës holandeze "Diplomat", presidenti i Kosovës gjatë qëndrimit në Holandë ka numëruar tri sfidat më të rëndësishme, ku një prej tyre është edhe përmbyllja e dialogut me Serbinë.

"Si Kosova, ashtu edhe Serbia, duan të jenë pjesë e Bashkimit Evropian dhe të dy shtetet e dimë se duhet ta njohim njëri-tjetrin. BE-ja nuk do të na pranojë me probleme. Ne kemi nevojë për një marrëveshje ligjërish të detyrueshme. E di se do të jetë jashtëzakonisht e vështirë për të dyja palët, sidomos për Kosovën. Por, jam i bindur se dialogu dhe marrëveshja janë e vetmja rrugë përpara", ka thënë Thaçi.

Kjo revistë shkruan se sfida tjetër për Kosovën është ekonomike. "Kosova po vazhdon të shënojë rritje ekonomike,



por ka nevojë për të krijuar më shumë vende pune. Ne duhet të përqendrohemi në ekonominë e re dhe në mundësitë e reja. Nuk është e lehtë dhe ne ende duhet të bëjmë më shumë reforma strukturore", citohet të ketë thënë Thaçi.

Ndërkaq sfida e tretë, presidenti

Thaçi ka thënë se ka të bëjë me integrimin e Kosovës në NATO dhe BE, ku sipas tij, Kosova po punon në përmbushjen e kriterëve demokratike në politikë, ekonomi dhe legjislacion. Revista më e vjetër diplomatike në Holandë ka shkruar edhe për librin biografik për Hashim

Thaçin "New State, Modern Statesman", të promovuar para shumë përfaqësuesve të shtetit holandez, diplomatëve, ambasadorëve, gazetarëve dhe përfaqësues të shoqërisë civile në Institutin holandez për Marrëdhënie Ndërkombëtare "Clingendael".

Rama dhe Tsipras takohen në Londër, bisedojnë për detin

TIRANË, 8 KORRIK - Marrëveshja që pritet që të firmoset mes Shqipërisë dhe Grekisë për problemet e vjetra mes dy vendeve ka qenë në fokus kryesor në të dyja anët e kufirit në muajt e fundit.

E ndërsa në fillim të muajit qershor nga ministri i Jashtëm

grek Kotzias u paralajmërua se në fillim të korrikut do të firmoset marrëveshja, mediet në Athinë të shtunën shkruanin se do të shtyhet për shkak të presionit të opozitës greke ndaj qeverisë. Në kuadër të negociatave janë takuar disa herë në Greqi, por edhe në Shqipëri dy ministrat e jashtëm,

Bushati dhe Kotzias.

Por mediet greke të dielën njoftuan se Rama dhe kryeministri grek Tsipras do të takohen nesër (e martë) në Londër në kuadër të procesit të Berlinit, ku do të marrin pjesë vende të Ballkanit Perëndimor dhe vendet kryesore evropiane.

Referuar medieve greke, në qendër të takimit Rama-Tsipras pritet që të jetë finalizimi i marrëveshjes për kufirin detar. Gjithmonë, sipas medieve greke, qeveria e koalicionit Syriza dhe Grekët e Pavarur kanë pasur përplasje të ashpra ndaj Marrëveshjes së Prespës dhe



Tsipras duket se nuk është gati për një tjetër marrëveshje për momentin, pasi edhe reagimet do të ishin më të mëdha.

Koalicioni qeverisës e mbështet Thaçin për udhëheqës të dialogut

Presidenti Hashim Thaçi ka marrë mbështetjen e koalicionit qeverisës për ta drejtuar procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Përfaqësuesit e subjekteve që janë pjesë e këtij koalicioni kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se Kushtetuta i jep legjitimitet presidentit Thaçit për ta përfaqësuar Kosovën në dialog. Megjithatë, sipas tyre, është më se e nevojshme që për këtë proces të dialogut të arrihet konsensus politik

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 KORRIK - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hajdar Beqa, ka thënë se koalicioni qeverisës e përkrah presidentin Hashim Thaçi për ta përfaqësuar vendin në dialog me Serbinë. "Mazhoranca e përkrah Thaçin në këtë proces dhe jemi optimistë se nuk do të jetë ndonjë sfidë për Qeverinë përfaqësimi i presidentit në dialog, përkundrazi do ta forcojë edhe rolin e saj", ka thënë Beqa për gazetën "Epoka e re".

Deputeti Beqa ka bërë me dije se nuk ka kohë për të na prituri faktori ndërkombëtar derisa të pajtohet i gjithë populli se kush duhet ta përfaqësojë vendin në bisedime. Ai ka thënë se presidenti Thaçi është njeriu i duhur për ta udhëhequr fazën finale të dialogut me Serbinë. "Kemi ndërtuar institucionet të cilat kanë mandat kushtetues dhe duhet ta përfaqësojnë Kosovën sipas Kushtetutës. Prandaj presidenti Thaçi është njeriu më i duhur për ta përfaqësuar Kosovën në dialogun me Serbinë. Konsensusi është i nevojshëm, por nuk kemi kohë për të humbur. Tri vjet i kemi humbur me demarkacion, po t'i humbim edhe tri vjet me bisedime pasojat do t'i vuajnë qytetarët. Bisedimet duhet të vazhdojnë pavarësisht asaj nëse i përkrah apo jo opozita. Opozita deri tani ka pasur vetëm deklarime politike, por jo alternativë. Thaçi është president dhe bisedimet po zhvillohen në nivel të presidentësh dhe kjo nuk mund të ndryshohet. E përkrahim idenë e konsensusit, por jo të ndërpriten bisedimet. Bisedimet duhet të vazhdojnë deri në arrijen e njohjes reciproke në mes të dy vendeve. Natyrisht se në fund të këtij procesi Kosova do ta ketë një listë me kërkesa për Serbinë e cila ka kryer krime dhe gjenocid në Kosovë", është shprehur Beqa.

Edhe shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, i cili është edhe pjesë e strukturave të AAK-së, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se një bashkim i forcave politike të

deputetëve dhe institucioneve të dalin me një zgjidhje e cila është e pranueshme për të gjitha palët", ka deklaruar Arifi. Edhe Aleanca Kosova e Re (AKR), e cila është pjesë e qeverisë, përkrah presidentin Thaçi si dialogues në këtë proces. Presidenti i kësaj partie, i cili mban edhe postin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Jashtëm, Behgjet Pacolli, në takimin e fundit të presidentit Thaçi në Bruksel ka qenë i pranishëm.

Kryeministri Ramush Haradinaj disa herë ka treguar se është i pajtimt që në këtë proces ta përfaqësojë Kosovën presidenti Hashim Thaçi.

Zyra e kryeministrit javën e kaluar ka dorëzuar përpara kabinetit qeveritar raportin mbi arritjet dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit, i cili është dorëzuar në takimin e dytë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit mes Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës nga grupi i veçantë për normalizim.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se raporti evidenton të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në kuadër të dialogut të zhvilluar në Bruksel me autoritetet e Beogradit si dhe hapat e sfidat për realizimin e këtyre marrëveshjeve. Sipas tij, ky raport paraqet tërësinë e të dhënave të pranuar nga ekipet teknike që kanë qenë të përfshira në procesin e dialogut,

Mustafa: LDK-ja është unike në qëndrimet për dialogun me Serbinë

Lideri i Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se gjatë këtyre ditëve ka pritur në takim drejtuesit e institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare, me të cilët ka diskutuar për zhvillimet e fundit në skenën politike. Në këtë kontekst, ai ka treguar se kjo parti është unike në qëndrimet e saj sa i përket fazës përfundimtare të dialogut me Serbinë. Sipas Mustafës, LDK-ja si subjekt opozitar është duke dhënë kontribut në të gjitha fazat e shtetndërtimit të Kosovës. "Të shtunën prita kryeministrin Haradinaj, me të cilin diskutuam lidhur me qëndrimet e LDK-së për dialogun me Serbinë, qëndrime këto të cilat i kemi bërë publike si kryesi i LDK-së dhe nga takimi me kryetarët e degëve të LDK-së. Lidhja Demokratike e Kosovës ka dhënë kontributin e saj në të gjitha fazat e shtetndërtimit të Kosovës dhe këtë kontribut po e jep edhe tani si subjekt

opozitar parlamentar. LDK-ja është unike në çështjet madhore siç është edhe pozicionimi i saj lidhur me fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë. Të gjitha qëndrimet e LDK-së janë të koordinuara me Kryesinë e LDK-së, me nënkryetarët e LDK-së, me sekretarin e përgjithshëm, me shefin e grupit parlamentar, me nënkryetarin e Kuvendit nga radhët e LDK-së dhe me kryetarët e degëve të LDK-së", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka treguar se pas kthimit të tij në Kosovë para tre muajsh, ku akoma është në proces të rehabilitimit fizioterapeutik, e kanë vizituar presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli si dhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje Albin Kurti. Po ashtu, lideri i LDK-së, Isa Mustafa, është takuar edhe me diplomatët e huaj të akredituar në Kosovë.

përkatesisht shpreh gjendjen aktuale në procesin e dialogut. Raporti do të dërgohet në Kuvendin e Kosovës dhe do të

publikohet në mënyrë që të jetë i qasshëm edhe për publikun në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë.



Flet për "Epokën e re", Dardan Gashi

Diaspora duhet të bëhet



Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka thënë se të gjitha kërkesat e diasporës janë duke u marrë parasysh nga institucionet e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se diaspora duhet të bëhet pjesë e sistemit politik të Kosovës. Gashi ka treguar se është duke diskutuar me partitë politike që kërkesat e diasporës, si vendet e rezervuara në Kuvendin e Kosovës, themelimi i një televizioni për diasporën, kërkesa për kartonin e gjelbër, mësimi plotësues në gjuhën shqipe dhe kërkesa të tjera të bëhen realitet. Ai ka bërë me dije se partitë politike kanë mendime të ndryshme për përfaqësimin politik të diasporës në institucionet e Kosovës. "Një prej këtyre mendimeve është që diaspora t'i ketë në Kuvendin e Kosovës 5 deri në 6 vende të rezervuara", ka thënë Gashi

vendet diasporës, mirëpo problemi është se nuk funksionon sistemi zgjedhor për diasporën. Deri tash KQZ-ja ka dështuar të organizojë zgjedhje për diasporën", është shprehur Gashi.

Më tej, ai ka deklaruar se të gjitha kërkesat e diasporës janë marrë parasysh nga institucionet e Kosovës. "Një prej kërkesave të tyre ka qenë themelimi i një televizioni. Ne veçse kemi marrëveshje me Republikën e Shqipërisë për këtë çështje, pra RTSh-në dhe RTK-në, ku në bashkëpunim do ta themelojmë televizionin e diasporës. Kërkesa e tyre për kartonin e gjelbër, siç e thashë, është në procedurë e sipër. Pra, jemi në bashkëpunim me të gjithë partnerët relevantë për ta zgjidhur këtë çështje. Sa i përket mësimin plotësues në gjuhën shqipe, edhe këtë çështje e kemi trajtuar, por duhet të kihet parasysh se të gjitha kërkesat nuk mund të trajtohen dhe të realizohen përnjëherë", ka thënë Gashi.

"Epoka e re": Z. Gashi, diaspora edhe këtë vit, në fillim të muajit gusht, do të mbledhet në Prekaz. Cili do të jetë qëllimi i këtij manifestimi dhe pse pikërisht në Prekaz?

Gashi: Së pari, diaspora do të mbledhet në Prekaz sepse tashmë ky manifestim është bërë tradicional. Një arsye shtesë është se sivjet kemi shënuar 10-vjetorin e shpalljes së pavarësisë dhe njihet edhe si viti i Skënderbeut. Pastaj të dy qeveritë, e Kosovës dhe e Shqipërisë, kanë bërë marrëveshje që tash e tutje diaspora jonë të trajtohet si një trup sa iu përket qendrave kulturore, të drejtës për arsimim dhe shumë procedurave të tjera. Po ashtu, të dy qeveritë janë pajtuar për formimin e një televizioni të përbashkët për diasporën shqiptare. Natyrisht se edhe këtë vit do të mbledhemi aty, sepse ai vend e ka simbolikën e vet.

"Epoka e re": Tradicional është bërë edhe organizimi i shumë aktiviteteve në kuadër të

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka bërë me dije se diaspora duhet të bëhet pjesë e sistemit politik. Ai ka deklaruar se këtë çështje e kanë diskutuar me subjektet politike dhe ekziston vullneti që kjo të ndodhë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka thënë se për ta arritur

këtë qëllim duhet një reformë e listës zgjedhore. "Diaspora gjithqysh duhet të jetë pjesë e sistemit politik të Kosovës, duke pasur parasysh se ne kemi mbi 700 mijë banorë vetëm në Evropë që janë me orgjinë nga Kosova dhe që kanë të drejtën e votës. Mirëpo procesi, si i tillë, nuk ua mundëson që në mënyrë adekuate të jenë të përfaqësuar në sistem", ka thënë Gashi. Ai ka kritikuar KQZ-në që deri më tani nuk ka arritur të organizojë

zgjedhje për diasporën. Gashi ka treguar se me subjekte politike është diskutuar edhe çështja e vendeve të rezervuara në Kuvendin e Kosovës për diasporën. "Partitë politike kanë mendime të ndryshme për përfaqësimin politik të diasporës në institucionet e Kosovës. Një prej këtyre mendimeve është që diaspora t'i ketë në Kuvend 5 deri në 6 vende të rezervuara. Kjo nuk është problem, sepse ne mund t'ua rezervojmë edhe

pjesë e sistemit politik



manifestimit "Dita e Diasporës". Do të ketë ndonjë risi këtë vit?

Gashi: Manifestimet e këtij viti nuk do të kenë ndonjë dallim të

madh prej atyre të viteve të kaluara, përveçse shpresojmë se do të jetë pak më mirë, sepse në vitet e fundit kanë qenë pak më zbehtë

manifestimet e tilla. Do të ketë manifestime të ndryshme në disa komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës, duke përfshirë Prishtinën, Dardanën, Ferizajn, Rahovecin dhe disa komuna të tjera. Pastaj do të ndajmë mirënjohje për personalitete të caktuara që kanë dhënë kontribut për diasporën. Për këto mirënjohje do të vendosë një komision i cili veçse ka filluar tash të punojë për t'i përzgjedhur propozimet. Ndër të tjera, do t'i ndajmë edhe çmimet për gazetarin dhe storien e vitit për diasporë.

"Epoka e re": A keni marrë ndonjë veprim i cili do t'ua lehtësonte bashkatdhetarëve hyrjen në kufi apo lehtësimin e procedurave për pajisje me dokumentacion të nevojshëm?

Gashi: Këtë vit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme kemi mënjanuar një problem, që ka qenë pritja në kufi për marrjen e sigurimit shtesë, që duhet t'i paguajnë veturat që hyjnë me targa të huaja në Kosovë. Tash nuk ka nevojë të dilet prej makinës dhe të paguhet në kufi, por mund të blihet online. Shpresoj se bashkatdhetarët tanë kanë filluar ta përdorin këtë platformë, të cilën e kemi formuar në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës dhe Byronë e Sigurimeve të Kosovës. Mendoj se ky është një lehtësim jo i vogël, ani pse nuk kemi arritur ende ta mënjanojmë këtë pagesë. Dua të qartësoj këtu se këtë pagesë nuk e kërkon Qeveria e Kosovës, por është një problem që kompanitë e sigurimit të Perëndimit nuk e njohin sigurimin e kompanisë që hynë në Kosovë, për faktin se ende nuk jemi shtet anëtar i Kartonit të Gjellbër. Prandaj, jemi të obliguar t'i pajisim qytetarët

me sigurimin shtesë. Siç jeni të njoftuar, ne jemi në negociata për këtë çështje dhe kemi avancuar shumë. Besoj se brenda këtij viti do të arrijmë marrëveshje me shtetin e Austrisë ose me ndonjë shtet tjetër që të marrin përsipër Kartonin e Gjellbër për Republikën e Kosovës. Në këtë drejtim më nuk do të ketë nevojë të paguhet ky sigurim shtesë.

"Epoka e re": Në konferencën "Diaspora flet", që është organizuar nga Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim me organizatën "Germin", diaspora ka paraqitur pesë kërkesa për institucionet e Kosovës. Sa janë gjasat të realizohen ato kërkesa?

Gashi: Një prej kërkesave ka qenë themelimi i një televizioni. Ne veçse kemi marrëveshje me Republikën e Shqipërisë për këtë çështje, pra RTSH-në dhe RTK-në, ku në bashkëpunim do ta themelojmë televizionin e diasporës. Kërkesa e tyre për kartonin e gjellbër, siç e thashë, është në procedurë e sipër. Pra, jemi në bashkëpunim me të gjithë partnerët relevantë për ta zgjidhur këtë çështje. Sa i përket mësimin plotësues në gjuhën shqipe, këtë çështje e kemi trajtuar, por duhet të kihet parasysh se të gjitha kërkesat nuk mund të trajtohen dhe të realizohen përnjëherë. Mirëpo, e rëndësishme është se të gjitha kërkesat e diasporës janë marrë parasysh nga institucionet e Kosovës. Kurse kërkesa e diasporës për të drejtën e votës dhe përfaqësimin në politikëbërje, është çështje që duhet të diskutohet në mes të partive politike në Kosovë, në mënyrë që të dakordohen se si duhet ta rregullojnë këtë çështje. Ne i kemi disa propozime që i kemi marrë prej diasporës dhe i kemi trajtuar me partitë politike dhe kjo tani varet prej tyre.

"Epoka e re": Çfarë janë këto propozime që i keni marrë prej diasporës?

Gashi: Ne i kemi diskutuar dhe kemi insistuar ta fillojmë reformimin e listës zgjedhore. Në këtë proces Ministria e Diasporës do të jetë pjesë e çdo diskutimi me idenë që t'i përfaqësojë interesat e diasporës, në këtë rast interesat dhe kërkesat politike. Diaspora gjithqysh duhet të jetë pjesë e sistemit politik të Kosovës, duke pasur parasysh se ne kemi mbi 700 mijë banorë vetëm në Evropë që janë me orgjinë nga Kosova dhe që kanë të drejtën e votës. Mirëpo, procesi si i tillë nuk ua mundëson që në mënyrë adekuate të jenë të përfaqësuar në sistem. Ju e dini se prej 700 mijë personave kanë marrë pjesë vetëm 10 mijë prej tyre në zgjedhjet e kaluara. Kjo ka qenë pjesëmarrja më e lartë deri më tani, por që është larg prej nevojave që ka diaspora dhe të drejtën që ata e kanë për të qenë të përfaqësuar.

"Epoka e re": Përfaqësuesit e diasporës si kërkesë politike e përmendin shpesh edhe çështjen e vendeve të rezervuara në Kuvendin e Kosovës. E keni diskutuar këtë çështje me partitë politike dhe cili është vullneti i tyre?

Gashi: Partitë politike kanë mendime të ndryshme për përfaqësimin politik të diasporës në institucionet e Kosovës. Një prej këtyre mendimeve është që diaspora t'i ketë në Kuvendin e Kosovës 5 deri në 6 vende të rezervuara. Ky nuk është problem, sepse ne mund t'ua rezervojmë edhe vendet diasporës, mirëpo problemi është se nuk funksionon sistemi zgjedhor për diasporën. Deri tash KQZ-ja ka dështuar të organizojë zgjedhje për diasporën.

Sejdiu thotë se është i gatshëm të rikthehet në krye të LDK-së

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ish-presidenti Fatmir Sejdiu, i cili më herët ka qenë edhe kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ka shprehur gatishmërinë për t'u rikthyer në krye të kësaj partie. Ai në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë" ka thënë se ka energjinë dhe bagazhin për të qenë në krye të LDK-së. "Unë e kam dhënë përgjigjen time rreth kësaj pyetjeje që e shtroni ju, se është shtruar në forma të ndryshme. Gjithmonë kam qenë, jam dhe do të jem i gatshëm që nëse Lidhja Demokratike e Kosovës dhe njerëzit e saj

mendojnë se mund të jem në përgjegjësi të veçuara, në këtë rast edhe në udhëheqjen e partisë, jam i gatshëm, absolutisht po. Nuk jam njeri që insisto domosdo, absolutisht, por insisto që LDK-ja ta bëjë zgjedhjen më të mirë të mundshme. Në këtë rast, unë jam një nga njerëzit që kujtoj se e kam energjinë, e kam bagazhin tim, thjesht edhe politik, edhe përvojën jashtëzakonisht të bollshme, por ajo gjithmonë mund të begatohet dhe ta jap kontributin tim në çdo situatë", ka thënë Sejdiu. Ai ka theksuar se ka çështje me të cilat nuk është



pajtuar e nuk pajtohet as sot, me zhvillimet brenda LDK-së, megjithatë ka pohuar se LDK-ja

është një parti e fuqishme, pavarësisht prej nuancave kohore dhe momenteve që kanë qenë në

procese të caktuara zgjedhore. "LDK-ja ka një identitet real, një filozofi që ka themelet që nga dhjetori i vitit 1989, në atë kohë kur edhe presidenti Ibrahim Rugova merr timonin e saj. Tash kemi anëtarë jashtëzakonisht cilësorë që nuk janë në strukturat e sotme, por janë njerëz që nuk dalin në parti tjetër. Ata mund të kenë hidhërime edhe me LDK-në, mos ta vënë votën, mos të dalin në proces zgjedhor, por janë njerëz që nuk kanë lëvizur nga aty. Unë jam një nga njerëzit e tillë", ka thënë ish-kryetari i LDK-së, Fatmir Sejdiu.

Berisha: Zhvillimi dhe misioni i FSK-së nuk do të ndalet

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, ka reaguar ndaj kërkesave për largim nga Forca e Sigurisë së Kosovës të disa pjesëtarëve të komunitetit serb. Ai ka thënë se pjesëtarët e FSK-së nga komuniteti serb kanë qenë shumë mirë të integruar në nivel të përgjegjësive dhe detyrave të tyre. "Shantazhet dhe kërcënimet e bëra janë të papranueshme, janë shkelje e të drejtave themelore të njeriut", ka thënë Berisha



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, ka folur rreth kërkesave për largim nga FSK-ja të disa pjesëtarëve të komunitetit joshumicë serb. Ai ka bërë me dije se FSK-ja në ditët e fundit është duke u përballur me këtë dukuri.

Ministri Berisha ka theksuar se, sipas vlerësimeve të MFSK-së, këto kërkesa për largim vijnë si pasojë e sulmeve të qëllimshme që i janë bërë FSK-së, përkatësisht pjesëtarëve të komunitetit serb që janë tentim për t'i dëmtuar arritjet dhe zhvillimin e kësaj force si dhe imazhin e saj si institucioni më i besueshëm në vend për vite me radhë. "Ne ndiejmë keqardhje për pjesëtarët

tanë të cilët nuk janë lejuar të vendosin lirshëm për vazhdimin e karrierës profesionale, të ardhmes së tyre, duke ndikuar negativisht në mirëqenien e tyre dhe të familjeve të tyre. Pjesëtarët e FSK-së nga komuniteti serb kanë qenë shumë mirë të integruar në nivel të përgjegjësive dhe detyrave të tyre, prandaj shantazhet dhe kërcënimet e bëra janë të papranueshme, janë shkelje e të drejtave themelore të njeriut", ka thënë ministri Berisha.

Ai ka shtuar se diversiteti etnik dhe profesionalizmi i Forcës së Sigurisë së Kosovës është një vlerë që është e njohur dhe e pranueshme nga miqtë tanë ndërkombëtarë dhe shtetet anëtare të NATO-s. "Kjo vlerë është duke u penguar atyre që nuk ia duan të mirën Kosovës

dhe qytetarëve të saj, pavarësisht se cilit komunitet i takojnë. FSK-ja do të vazhdojë në përmbushje të misionit dhe zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve operacionale si dhe angazhimin për përfundimin e tranzicionit në

Forca të Armatosura të Kosovës (FAK) si forcë moderne mbrojtëse për Kosovën dhe popullin e saj pa asnjë dallim", ka thënë ai. Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, ka pohuar se rruga e Kosovës dhe e Forcës së Sigurisë

së Kosovës nuk do të ndalet. "FSK-ja ka qenë, është dhe do të jetë e hapur për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe gjithëherë do të jetë në shërbim të qytetarëve të saj", ka thënë ministri Berisha.

Lidhjet familjare e partiake, 'kriteret' për punësim

PRISHTINË, 8 KORRIK - Të rinjtë në Kosovë vazhdimisht ballafaqohen me vështirësi për të siguruar një vend pune, sidomos në sektorin publik. Përveç diplomës universitare, përcaktues kryesor në punësim në sektorin publik, sipas tyre, janë lidhjet familjare dhe ato partiake.

Vlora ka dy vjet që ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik dhe ka aplikuar në disa konkurse, por ajo dyshon se ryshfeti dhe familjarizimi ka ndikuar të mos punësohet. "Në institucionet e Kosovës janë krijuar klane. E për të siguruar një vend pune duhet që paraprakisht nga jashtë të bëhesh pjesë e klaneve. Unë nuk veproj në këtë mënyrë, pasi kam kualifikimet e nevojshme", thotë Vlora.

Lidhjet familjare, ryshfeti dhe lidhjet partiake përmenden në raportin e fundit të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë (UNDP) si faktorë që ndikojnë shumë për të siguruar një vend pune në sektorin publik në Kosovë. Sipas këtij raporti, 78 për qind e të anketuarve besojnë se lidhjet



familjare, ryshfeti dhe lidhjet partiake dhe faktorët e tjerë jomeritorë janë më të dobishme për sigurimin e një vendi pune. Kurse vetëm 22 për qind besojnë se arsimiti, përvoja dhe aftësimi profesional janë kriteret kryesorë

për punësim në sektorin publik. Edhe përfaqësues të shoqërisë civile thonë se sektori publik është i "rezervuar" për militantët të partive politike që vijnë në pushtet. Jeton Zulfaj nga organizata joqeveritare "Fol" ka thënë

për "Radion e Evropa e Lirë" se ky kriter, edhe pse jo ligjor, ka mbipopulluar sektorin publik në Kosovë. "Ne shohim një administratë të stërmëshur me persona të lidhur me subjekte politike, të cilët më tepër llogariten si

vota dhe jo si punëtorë të shtetit", ka thënë Zulfaj, duke vlerësuar se punësimi pa kriter në sektorin publik ka rezultuar me një administratë jokualitative dhe joprofesionale. "Qytetarët e Kosovës nuk mund të presin punë efektive dhe profesionale nga shumica e punëtorëve në institucionet publike. Kjo gjendje nuk i pengon zyrtarët e lartë politikë të cilët nuk kanë hallin të garantojnë një administratë publike e cila bazohet në meritë", ka thënë Zulfaj për "REL". Mbi 80 mijë persona llogariten punonjës në sektorin publik, me një pagë mesatare 525 euro në muaj. Bashkimi Evropian në vazhdimësi ka kërkuar reforma në administratën publike në Kosovë si nevojë me prioritet për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Sidoqoftë, shkalla e papunësisë në Kosovë, sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave (ASK) për tremujorin e parë të këtij viti, është 26.5 për qind. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeç, me 54 për qind.

Një familje pesanëtarëshe humbi jetën të dielën në një aksident trafiku në fshatin Biraç të Suharekës

Erdhën për pushime në vendlindje, humbën jetën në aksident trafiku

Të dielën rreth orës 13:21 minuta në magjistralen Suharekë - Duhel ka ndodhur një aksident i rëndë komunikacioni, me ç'rast kanë humbur jetën pesë anëtarë të një familjeje, në mesin e tyre tre fëmijë. Kjo familje kishte ardhur nga Zvicra për pushime në vendlindje. Policia e Kosovës ka apeluar te të gjithë pjesëmarrësit në trafik, në veçanti te drejtuesit e automjeteve, të jenë të kujdesshëm gjatë drejtimit të automjeteve



**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 KORRIK - Të dielën humbën jetën në një aksident trafiku në fshatin Biraç të Suharekës pesë anëtarë të një familjeje, në mesin e tyre tre fëmijë. Kjo familje kishte ardhur nga Zvicra për pushime në vendlindje.

Zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Prizrenit, Hazir Berisha, ka dhënë detaje rreth aksidentit tragjik. "Aksident i rëndë komunikacioni në Biraç të Suharekës. Rreth orës 13:21 minuta në magjistralen Suharekë - Duhel ka ndodhur një aksident i tmerrshëm komunikacioni, me ç'rast kanë humbur jetën pesë persona: dy të rritur dhe tre fëmijë. Vdekjet janë konfirmuar nga emergjenca e cila ka dalë në vendin e

ngjarjes. Aksidenti ka ndodhur në mes të një automjeti të llojit 'BMW' dhe një autobusi", ka bërë me dije Berisha.

Ndërkaq Policia e Kosovës ka bërë me dije se me qëllim të ngritjes së sigorisë në trafikun rrugor, ngritjes së vëmendjes për një kujdes më të shtuar për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, në vazhdimësi është duke ndërmarrë veprime policore të cilat kontribuojnë në ngritjen e nivelit të sigorisë në trafik. "Edhe pse gjatë këtij gjashtëmuajori kemi rënie të aksidenteve fatale për (-19.61 %), ndërsa rënie në total të aksidenteve prej (-13.25 %), Policia e Kosovës, me qëllim të reduktimit të aksidenteve në trafikun rrugor, vazhdon të apelojë tek të gjithë pjesëmarrësit në trafik, në veçanti te drejtuesit e automjeteve, të jenë të kujdesshëm dhe sa më vigji-

lentë gjatë drejtimit të automjeteve të tyre. Vëmendje kërkohet, posaçërisht në këtë periudhë kur kemi të reshura atmosferike, ku mund të ketë kufizim të dukshmërisë, rrugët mund të bëhen më të rrëshqitshme dhe qarkullimi nëpër rrugë vështirësohet", është thënë në komu-

nikatën për medie të policisë. Më tej në këtë komunikatë thuhet se Policia e Kosovës me njësitet e saj do të vazhdojë të monitorojnë dhe ta menaxhojnë situatën në trafikun rrugor nëpër të gjitha rrugët e vendit dhe aty ku pjesëmarrësit bien ndesh me rregullat në trafik.

"Masa ndëshkuese ligjore do të aplikohen me qëllim të parandalimit të rasteve të aksidenteve, në veçanti atyre me fatalitet që po paraqesin shqetësim për të gjithë dhe po shkaktojnë humbje të jetëve njerëzore", është thënë në komunikatën e policisë.

Veseli: Nga sot fillon Dekada e Re për PDK-në dhe Kosovën

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, në Konventën e Gjashtë Zgjedhore të Rinisë Demokratike, ku kryetari i ri është zgjedhur Donjet Bislimi, ka thënë se nga sot fillon Dekada e Re për PDK-në dhe Kosovën

**EPOKA
ERE** Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë të dielën para mijëra të rinjve që i janë bashkuar PDK-së për Dekadën e Re, se nga sot po fillon jetësimi i platformës politike e cila do ta transformojë dhe fuqizojë PDK-në dhe Kosovën. Ai ka thënë se në tre muajt e fundit ka udhëtuar në çdo vend të Kosovës, ka takuar me mijëra vajza e djem në fshatrat dhe qytetet e saj për të dëgjuar idetë e të rinjve për qytetin e tyre, për shkollën, familjen, shtetin dhe shoqërinë. "I kam dëgjuar ëndrrat dhe shpresat e tyre për të ardhmen. Dhe,

kam marrë besimin e tyre për t'i bërë agjendë shtetërore idetë e tyre. Të rinjtë e Kosovës i besojnë Partisë Demokratike dhe duan të jenë pjesë e saj. Ata janë sot me ne. Ata janë vetë Partia Demokratike e Kosovës në Dekadën e Re", ka thënë kryetari i PDK-së, Kadri Veseli. Ai ka shtuar se në dy dekadat e fundit Kosova ka bërë progres të madh. "Askush s'do ta besonte. Por, ky është fakt i pamohueshëm. Atdheu ynë është i lirë dhe shtëpi e sigurt për secilin qytetar. Kemi modernizuar vendin. Kemi ndërtuar infrastrukturën më bashkëkohore në rajon dhe kemi ngritur pagat për çdo kategori. Njerëzit tanë jetojnë më mirë", ka thënë Veseli.



Donjet Bislimi, kryetar i Rinisë Demokratike

Donjet Bislimi është zgjedhur kryetar i Rinisë Demokratike, me mandat katërvjeçar, me zotimin e fuqishëm për ta çuar përpara çështjen e rinisë, me platformën e së ardhmes së saj, me Dekadën e Re. Në Konventën e Gjashtë Zgjedhore të Rinisë Demokratike, me pjesëmarrjen e të gjitha degëve

të Rinisë Demokratike me delegatët sipas statutit, si dhe strukturat e Rinisë Demokratike, morën pjesë në diskutime dhe i kontribuuan procesit zgjedhor demokratik, të hapur, transparent, garues, gjithëpërfshirës dhe përfaqësues. Në fjalën e tij, Donjet Bislimi, para delegatëve ka porositur të rinjtë e Partisë Demokratike ta ndjekin rrugën e liderëve të PDK-së, të cilët në moshën e rinisë arritën lirinë

dhe pavarësinë, ndërsa sot, të rinjtë me Dekadën e Re, të arrijnë zhvillim dhe integrim me besim. Donjet Bislimi është 23-vjeçar nga Mitrovica. Ai është në vitin e gjashtë të studimeve në Fakultetin e Mjekësisë. Donjeti është shef i Grupit të Asamblistëve të Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin Komunal në Mitrovicë. Ai ka qenë asamblisti më i votuar në Mitrovicë.

Flet për "Epokën e re", Sami Mazreku

Më pak se një për qind e qytet

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se më pak se 1 për qind e qytetarëve të Kosovës kanë sigurime jetësore. Sipas tij, qytetarët e Kosovës shpenzojnë vetëm 44 euro në vit për sigurime, që përbën vlerën më të ulët në rajon. Mazreku ka theksuar se industria e sigurimeve përballet me mjaft sfida, duke filluar nga legjislacioni tatimor

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 KORRIK -

"Epoka e re": Z. Mazreku, kohën e fundit u raportua se sektori i sigurimeve në Kosovë përbën vetëm tre për qind të tregut të përgjithshëm. Sipas jush, pse përballemi me këtë shifër?

Mazreku: Po, është e vërtetë. Sipas raportit vjetor të BQK-së, industria e sigurimeve merr pjesë me vetëm 3 për qind në vlerën e aseteve të sektorit financiar. Sektorit bankar dhe fondit pensional janë të mëdhenj, prandaj me automatizëm e bën industrinë e sigurimeve të ketë pjesëmarrje të vogël në strukturën e aseteve. Tregu i sigurimeve është shumë i vogël, primi i shkruar vjetor (pra të hyrat, jo profiti) janë 84 milionë euro dhe në kuptim të penetrimit (Primi i shkruar/GDP e vendit) dhe densitetit (Primi i shkruar për kokë banori) janë më të voglat në rajon (përfshijto këtu Shqipërinë). Një ndër arsytet për shifra të tilla të ulëta është sistemi tatimor në Kosovë, i cili i ngarkon kontratat e sigurimit me 24.35 për qind taksa. Një politikë e tillë tatimore nuk haset në asnjë vend të rajonit e mos të flasim për vendet e BE-së. Në asnjë vend kompanitë e sigurimit nuk taten me shkallë prej pesë përlindësh në të hyra, por taten në profit

real. Kurse sa i përket TVSh-së, sigurimet janë të lira nga TVSh-ja si në rajon ashtu edhe në BE. Këto taksa paraqesin mjaft ngarkesë për penetrimin e tregu, pasi është ngarkesë e konsiderueshme për blerësin. Tutje, numri mjaft i madh i kompanive të sigurimit, në një treg kaq të vogël ka ndikuar që çmimet e sigurimit të jenë shumë të ulëta, gjë që pengon akumulimin e aseteve. Gjithashtu, si pasojë e rregullatave ligjore për sistemin Bonus Malus të aprovuar nga BQK-ja, primi i sigurimit në klasën më të madhe të sigurimeve zvogëlohet për çdo vit. Veç të tjerash, kjo mendoj se ka të bëjë edhe me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në vend, me mirëqenien sociale, me fuqinë blerëse të qytetarëve.

"Epoka e re": Llogaritet se deri në 30 për qind e veturave në Kosovë nuk janë të regjistruara. Çfarë humbjesh ju shkakton?

Mazreku: Kjo është një prej problemeve më të mëdha me të cilat industria e sigurimeve është ballafaquar nga paslufta. Realisht, ky fenomen ka ndikuar edhe në problemin e shtjelluar në pyetjen paraprake. Të dhëna të sakta për numrin e automjeteve të paregjistruara s'ka, por bazuar në studime të ndryshme e prononcime të ndryshme flitet për një numër rreth 15 për qind, por ka pas deklarata që është



edhe rreth 30 për. Sipas një analize të përgatitur nga industria, vlerësohet të jetë rreth 35 000 - 40 000 automjete. Nëse bazohe mi në këtë numër, kompanitë e

sigurimeve humbin të hyra vjetore rreth pesë milionë euro. Por, s'janë vetëm kompanitë e sigurimeve që humbin, është edhe buxheti i shtetit që hum-

bet po aq të hyra si pasojë e mosinkasimit të taksave të regjistrimit, TVSh-së etj. Përtej humbjeve në të hyra, kompanitë e sigurimit janë të obliguar

Kurti: 10 për qind e familjeve në Kosovë paguajnë ryshfet



PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se vetëm 10 për qind e familjeve në Kosovë paguajnë ryshfet kur marrin shërbime bazë. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se nuk ka pjesëmarrje masive në korrupsion. Kurti ka thënë se luftimi i korrupsionit në vendin tonë nuk është i pashpresë. "Vetëm 10 për qind e famil-

jeve në Kosovë paguajnë ryshfet kur marrin shërbime bazë. Dmth. nuk ka pjesëmarrje masive në korrupsion. Ajo është shumë më e ulët sesa në vendet e afërta. P. sh., në Mal të Zi është 34 për qind, sipas Barometrit Global të korrupsionit të Transparency International 2016, cituar te Draft Strategjia Shtetërore kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Plani i Veprimit. Pra, për ta luftuar korrupsionin në

Kosovë nuk është gjendja aq e pashpresë - korrupsioni është i madh, sepse i lartë në nivele të larta, por jo edhe aq i përhapur. Problemi është se prokurorët dhe gjyqtarët më shumë i frikësohen Qeverisë dhe oligarkëve sesa anasjelltas. Si një këngëtar që nuk këndon, i këtitillë është kryeprokurori Aleksandër Lumezi: kryeprokuror pa (krye)aktakuza", ka shkruar Kurti.

arëve kanë sigurime jetësore

"Epoka e re": Cili lloj i sigurimit është më i kërkuar nga qytetarët e Kosovës sa i përket atyre jetë dhe jo jetë. Pra, cilat janë shifrat?

Mazreku: Sigurimi i autopërgjegjësish ndaj palëve të treta - "TPL", është më i kërkuari, sigurim ky i detyrueshëm për regjistrimin e automjetit. Ky lloj sigurimi merr rreth 60 për qind të primit të përgjithshëm vjetor. Lloji i dytë është sigurimi shëndetësor privat, që përbën rreth 15-16 për qind të primit vjetor, shifër kjo mjaft e lartë që vjen si pasojë e mosfunksionimit të sigurimit shëndetësor publik. Sigurimi i pronës nga zjarri përbën vetëm 4.7 për qind të të hyrave, ndërkohë që sigurimi i jetës përbën më pak se 1 për qind të primit të shkruar vjetor. Thënë në përgjithësi, qytetarët e Kosovës shpenzojnë mjaft pak për sigurime. Në Kosovë, një banor shpenzon mesatarisht 44 euro në vit në sigurime, ndërkohë që kjo shifër është 65 euro në Maqedoni, 124 euro në Mal të Zi, 274 euro në Kroaci e 970 euro në Slloveni.

"Epoka e re": Sa ka interesim nga investitorët e huaj për të investuar në sektorin e sigurimeve tani, sepse janë larguar tri kompani të sigurimeve nga Kosova?

Mazreku: Tek kompanitë e sigurimit të jetës kemi dy kompani, njëra sllovene, tjetra austriake-shqiptare. Tek kompanitë e sigurimit jo-jetë, nga gjithsejtë 12, dy janë nga Shqipëria, 2 austriake, por të konsoliduara në Shqipëri, një është sllovene dhe të tjerat, pra 7 janë vendore. Në vitet e fundit kemi pasur tërheqje të investitorëve të huaj në këtë industri. Është tërhequr "Croatia Sigurimi" nga Kroacia, "GRAWE", nga Austria është tërhequr nga dy kompanitë jetë dhe jo-jetë me të cilat ka ushtruar aktivitet si dhe kemi pas tërheqjen e një investitori nga Turqia. Andaj, si rrjedhojë e kësaj mund të them se problemet e lartcekura ishin arsytet e largimit të investitorëve të huaj. Ndërkaq, s'ka pas interesim të investitorëve të rinj. Kjo paraqet një shqetësim për një vend si Kosova, ku investimet e huaja direkte janë të një interesi të veçantë për zhvillimin ekonomik të vendit.

"Epoka e re": Sektorët më të rrezikuar në Kosovë si policia dhe zjarrfikësit nuk kanë sigurime. Çfarë duhet të bëhet në këtë drejtim?

Mazreku: Në parim, ekzistojnë tri lloj të sigurimeve (mbulesave siguruese) që ofrohen në treg dhe që do të mund t'i siguronin

shërbyesit e përmendur, siç janë: Sigurimi nga aksidentet personale, që do të ofronte një shumë zhdëmtimi - kompensimi në rast të vdekjes apo invaliditetit si pasojë e aksidentit. Sigurimi shëndetësor, që ofron rimbursim të shpenzimeve që krijohen për të siguruarin për të trajtuar një sëmundje. Sigurimi jetësor, që do të ofronte një përfitim për anëtarët e familjes të të siguruarit me rastin e vdekjes së tij (pa marrë parasysh nga aksidenti apo vdekje e natyrshme). Që të tria këto lloj të sigurimeve mbulojnë aspekte të ndryshme të rrezikut dhe e kompletojnë njëra-tjetrën. Personalisht, mendoj se policët, zjarrfikësit dhe shërbyesit e tjerë të kenë që të tria këto mbulesa. Jo se me këtë do të nënkuptohej vetëm për të hyra shtesë për industrinë, porse me këtë do të sigurohej një mirëqenie për policët, për familjet e tyre dhe për shoqërinë në përgjithësi. Por, kjo çështje ka edhe implikime buxhetore dhe, si e tillë, u mbetet politikbërësve që të vendosin për këto sigurime. Në tregun e sigurimeve ofrohen të gjitha këto lloje të sigurimeve andaj u mbetet organeve kompetente për të vendosur për sigurimin e mundshëm të tyre.

"Epoka e re": Ka ankesa të shumta nga qytetarët e Kosovës se ka vonesa për kompensim në rast të aksidenteve edhe pas verdiktit të sistemit gjyqësor. Pse po ndodh kjo?


Mazreku: Duhet ta kuptoni se procesi i trajtimit të dëmeve dhe kompensimi i qytetarëve në rast të aksidentit është proces mjaft delikat. Në asnjë rast i dëmtuari s'ka të drejtë të shpërblehet për dëmin më shumë se sa që është vlera reale e dëmit, por as edhe më pak. Në praktikë, jo gjithëherë mund të vijmë tek vlera reale e dëmit, kjo posaçërisht vlen për rastet me lëndime trupore apo edhe me vdekje. Në këto raste procesi gjyqësor mund të zgjasë shumë, por kjo s'është dukuri vetëm tek ne, por është në të gjitha vendet për shkak të kompleksitetit të punës.

Gjykatat në Kosovë po bëhen më efikase çdo ditë e më shumë dhe në rast se të dëmtuarit s'arrijnë marrëveshje direkte në procedurë jogjyqësore me kompaninë e sigurimit, ata mund t'i adresohen gjykatës. Në momentin që vendimi i gjykatës është i ekzekutueshëm nga Gjykata e Apelit, një vendim i tillë duhet ekzekutuar, edhe pse kompanitë e sigurimit mund të vazhdojnë tutje me procedura ligjore në Gjykatë Supreme të Kosovës. Madje, të dhënat statistikore të

publikuara nga BQK, ato tregojnë për një numër mjaft të madh të qytetarëve të kompensuar. Në vitin 2017 kanë qenë gjithsejtë 139 796 dëme të paguara në vlerë prej 42 845 505 euro (në vitin 2016 ka qenë në vlerë prej 37.2 milionë eurosh). Bazuar në atë se për t'u kompensuar një dëm, pala e aksidentuar duhet të pajtohet me kompaninë e sigurimit lidhur me vlerën e kompensura, kjo do të thotë se 139 796 qytetarë gjatë vitit 2017 janë pajtuar me kompaninë e sigurimit lidhur me vlerën e dëmit. Natyrisht, kur kemi një numër kaq të madh të dëmeve, mund të ketë edhe vonesa të mundshme, gjë që mund të vijë nga gabimet, apo edhe se kompanitë duhet të jenë shumë të

kujdesshme për t'i ndalur keqpërdorimet eventuale. Jemi dëshmitarë që kohët e fundit Policia e Kosovës ka arrestuar grupe kriminale që kanë inskenuar aksidente për të përfituar nga sigurimi.

Në Kosovë numri i aksidenteve është mjaft i madh përfshirë ato me fatalitet dhe në Kosovë në çdo 1000 automjete, rreth 65 prej tyre shkaktojnë aksident. Në Slloveni ky numër është gati përgjysmë më i vogël, gjithsejtë rreth 35. Kjo do të thotë, se shumë më shumë ka aksidente këtu, shumë më tepër aksidente me fatalitet, më shumë aksidente më dëme materiale. Të gjitha këto dëme duhen trajtuar dhe paguar nga kompanitë e sigurimit dhe procesimi i tyre s'është i thjeshtë.



Lekaj: Tuneli i 'Alpeve Shqiptare' e shkurton rrugën për në Mal të Zi rreth 45 minuta

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka bërë me dije se tuneli i "Alpeve shqiptare" do ta shkurtojë rrugën për rreth 45 minuta me Malin e Zi dhe do ta lidhë Pejën me Rozhajën. "Peja do të lidhet me korridore të rëndësishme ndërkombëtare. Autostrada e 'Dukagjinit' dhe tuneli i 'Alpeve' do ta bëjnë atraktive këtë pjesë të Kosovës për investime serioze në turizëm, bujqësi e agrokulturë, për çfarë fermerët dukagjinas janë të njohur. Këtë vit do të përfundojmë planifikimin. Në vitin tjetër do t'i shohim rezultatet konkrete në këtë drejtim", ka shkruar Lekaj në llogarinë e vet në "Facebook".

A ka një vend tjetër afër Italisë, ku fjala paqe mund të tingëllojë më fort se Kosova?



Nga Behgjet PACOLLI,
ministër i Jashtëm i Kosovës

Zoti deshi që të gjendesha në Bari dhe të bëhesha pjesë e "pelegrinazhit të paqes dhe bashkimit", si e quajti Papa Françesku, Ditën Ekumenike të Paqes në këtë qytet, dritare të Italisë drejt Lindjes.

Arsyeja fillestare pse jam këtu? Promovimi në italisht i librit tim autobiografik, "asgjë nuk është e pamundur" në festivalin e librit "Libri i mundur", në Polignano a Mare. Libri im është saktësisht libri i jetës së një shqiptari global për të cilin dielli lind atje ku perëndon. Është libri i dikujt që me energjinë e krijuar në Lindje, me dituritë e fituara në Perëndim, si një pacifist i bindur ka punuar dhe punon në shërbim të paqes. Në shërbim të paqes luftoj dhe sot me cilësinë e ministrit të Jashtëm kur Kosova martire, pas 10 vjetësh pavarësi, ka kontribuar në paqësimin e rajonit dhe në fund të këtij viti e mbyll kapitullin e mosmarrëveshjeve me Serbinë me një marrëveshje detyruese paqeje.

Në këtë ditë lutjeje dhe refleksioni, do të doja që nëpërmjet faqeve të një gazete historike si "Gazzetta del Mezzogiorno" të ofroja dhe unë gjykimet e mia për paqen në Ballkan dhe atë në botë. E ndiej shumë ta bëj këtë, në mes të kësaj atmosfere frymëzuese që prania e Atit të Shenjtë po krijon në Puglia dhe nëpërmjet saj në Lindje dhe në gjithë botën. Si mund të kuptohet lutjet dhe reflektimin do t'i bëjnë Papa, si autoritet moral dhe autoritetet fetare në forumet e ndryshme gjatë kësaj dite në Bari, kushtuar paqes. Unë thjesht dua të kontribuoj për paqen me disa ide të qarta

për ekonominë, mbështetur mbi përvojën time 40-vjeçare si ndërmarrës global.

Paqja nuk mund të ndërtohet pa zhvillim ekonomik dhe zhvillimi ekonomik as që mund të mendohet pa paqe, ngjan kjo një thënie e vetëkuptueshme. "Kemi nevojë për një përgjigje globale që ballafaqohet me shkaqet e konfliktit dhe për bashkon paqen, zhvillimin e qëndrueshëm dhe të drejtat njerëzore në mënyrë tërësore nga konceptimi deri në ekzekutim", ka thënë sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres. E në këtë kontekst dua të përcjell (megjithëse nuk e kam zakon të citoj vlerësimet për mua), disa fjalë thënë nga profesor Andrea Riccardi, një aktivist i njohur i paqes në botë, në emër të komunitetit Sant Egidio. Këto fjalë janë burim krenarie për mua, për më shumë janë brenda lajtmotivit të paqes, ndërtuar mbi mirëqenie, e cila arrihet sigurisht nëpërmjet zhvillimit ekonomik si ilaç për t'i zbutur ndarjet, fërkimet ndëretnike. Janë fjalë të thëna pikërisht me rastin e promovimit të librit tim në Romë në janar të këtij viti "... Ne nuk jemi përballë vetëm një nacionalisti shqiptar, (ka shumë prej tyre dhe kemi respekt për ta), por jemi përballë edhe një njeriu që ka shumë misionë si, për shembull, të dikujt që kërkon të heqë kufijtë e Ballkanit dhe të rindërtojë një zonë paqeje të cilën ai e quan "paradhoma e Evropës". Unë uroj që kjo të realizohet sepse Evropa jonë ka shumë probleme dhe ka nevojë për dhoma dhe për paradhoma".

Po, unë mendoj se ekonomia mund të jetë kontribuuesja më e madhe e paqes në rajonin tonë të njohur për konfliktet e fundit. Veçoj këtu projektet e mëdha ekonomike që zhvlehtësojnë kufijtë sikur Evropa e Bashkuar. 1) Ndaj jam në favor të një zone të lirë ekonomike evropiane ndërkufitare në Kosovën veriore dhe Serbinë Jugore si një prej hapave për t'u kryer menjëherë. E shoh Italinë si kontribuuese kryesore në këtë projekt. Nuk jemi në kohën e betejës së

Kosovës së 1389 kur, sipas mitologjisë dehëse, me kosto të ulët për popullin e thjeshtë, një princ serb udhëhiqte frontin e popujve të Ballkanit kundër rrezikut që vinte nga larg. Jo, sot, para pak muajsh homologu im serb këndon turqisht këngën e Osman Agait - një këngë mesjetare otomane gjithashtu dhe Turqia është ndër investitorët kryesore në Serbi. Serbia që ka vetëm retorikë agresive apo viktimizuese ndaj Kosovës, është partnerja tregtare e Kosovës, me gjithë angazhimin e qeverisë dhe timin për t'i diversifikuar burimet e furnizimit me mallra me origjinë të ndryshme.

2. Vendet tona po harxhojnë shumë për rrugë të brendshme; hekurudhat tona lëngojnë në një krizë vetëshkatërruese; kompanitë tona ajrore mbijetojnë me vështirësi. Po vijam kështu, koston për ndërlidhje do të rriten më shumë nëse ne na mungon vizioni rajonal i zhvillimit. Ne duhet të ndërtojmë holdingje rajonale hekurud-

hore, autostrada, ajrore etj., që t'i ulim koston, që t'i rrisim kompetivitetin, që t'i shërbejmë paqes, pajtimit në rajon. Një kompani italiane pse jo, mund të jetë ortak themelues. Ka dhe ide e projekte të tjera, por nuk po zgjatëm.


Ndaj më në fund, një ftesë: Ditën Ekumenike të Paqes, vitin tjetër hajde bëjeni në Kosovë. Po jua ilustruj shumë thjesht pse ftesa ime është shumë e qëlluar: I përkas një kombi ku fjala e Krishtit është përhapur që herët si thotë Ungjilli. Prej Kosovës vjen shenjtorja më e re, Shën Tereza, që e kam njohur në vitin 1979.

Brenda kombit tim, brenda tokës sime, janë të pranishme dhe bashkëjetojnë të tria fetë, ndonëse ajo islame është më dominante. Në trojet tona ka kisha ortodokse të ngritura në themele të kishave të Krishtërimit të të hershëm, të mbrojtura nga populli i Kosovës më së shumti myslimanë; jam mysliman që vij nga një zonë

malore ku islami mbërriti vonë pikërisht për shkak të maleve që pengonin qarkullimin, por edhe përqaftimin e bindjeve fetare "të tjetrit"; jam martuar me një zonjë ortodokse ruso-buriate që mbron dhe propagandon kulturën e kombit tim më shumë sesa shumë bashkëkombës të mi, ja detyrojmë mbijetesën tonë moderne mbrojtjes së Perëndimit me aksionin e tij më 1999.

Ndaj pas këtyre argumenteve po e mbyll kësaj reflektimi tim për paqen: A ka një vend tjetër në zemër të gadishullit ballkanik afër Italisë, ku fjala Paqe mund të tingëllojë më fort se Kosova?

(Ky editorial i shkruar nga ministri i Jashtëm dhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli, është publikuar në njërin nga gazetat më të mëdha të Jugut të Italisë, "La Gazzetta del Mezzogiorno", me rastin e "Ditës Ekumenike të Paqes")



Nga e marta do të ketë stabilizim të motit

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka njoftuar se gjatë pesë ditëve të ardhshme do të ketë stabilizim të motit, përjashtuar ditën e hënë dhe pjesërisht të martën, ku pritet të ketë reshje shiu dhe shkarkime rrufesh. "Nga e mërkura sërish do të ketë ngritje të temperaturave në të dy vlerat ekstremale duke iu përgjigjur mesatareve të viteve të tjera. Të enjten sërish do të ketë kushte

për reshje shiu, por që nuk do të reflektohen në uljen e vlerave termike. Temperaturat minimale do të lëvizin nga 13-16 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihet të lëvizin ndërmjet 27-30 gradë celsius, përjashtuar dy ditët e para të javës ku maksimalet do të lëvizin ndërmjet 21-24 gradë celsius. Do të fryjë erë kryesisht nga verilindja me shpejtësi maksimale deri 6m/s", ka njoftuar IHMK-ja.

Shpend Ahmeti: Shiu po e pengon dezinfektimin e mushkonjave

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka njoftuar qytetarët se ka përfunduar edhe faza e dytë e dezinfektimit të mushkonjave dhe se kanë mbetur edhe katër faza të tjera për t'u përfunduar. "Dy valë të dezinfektimit kanë përfunduar

dhe kanë mbetur edhe katër. Mirëpo, kur ka të reshura efekti është minimal. Valën e tretë ende nuk po e fillojmë sepse deri të mërkurës pritet të ketë shi. Në momentin kur kemi së paku një periudhë dyditore pa shi, komuna fillon menjëherë valën e tretë,

përndryshe efekti i dezinfektimit është i pavërejtur. Krejt regjioni ku ka shi si këtë sezon po ballafaqohet me të njëjtin problem. Komuna e Prishtinës përmes Drejtorisë së Shëndetësisë do t'ju mbajë të informuar për oraret", ka bërë me dije Ahmeti.



PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (4)



Hajdin ABAZI

3. Një ngatërresë themelore

Kultura e krijuar deri tash konsiston që aspekti metodologjik të formulohet me një ose dy paragrafë, zakonisht ndër më të shkurtritur. Me këtë pretendohet se është kryer puna. Zakonisht, me nga një fjali përmenden një sërë metodash, duke thënë se me to do të realizohet studimi. Edhe kaq, sigurisht, është më mirë se sa hiç. E në të njëjtën kohë, kjo tregon se sa larg jemi nga standardet bashkëkohore të bërjes shkencë ose të realizimit të studimeve të ndryshme.

Një përkushtim më serioz shprehet kur në disa punime i kushtohet gjysmë faqe përcaktimit metodologjik. Si përpjekje, gjithsesi, është për t'u çmuar, por sapo të lexohet ajo, bie në sy cektësia ose syprinieteti, dhe hetohet mungesa e njohurive metodologjike. Të ngjanë si një detyrë që bëhet vetëm pse duhet bërë.

Një çështje më vete është fakti se hetohet edhe një ngatërresë themelore: përcaktimi i metodave hulumtuese dhe i metodologjisë. Të dyja këto, gjithsesi, janë të lidhura, por edhe dallojnë. Nuk janë identike dhe sidomos nuk janë një e njëjta gjë.

Për t'u shprehur shkurtimisht, metodat janë teknikat, mënyrat e qasjet do të përdoren si instrumente për të realizuar studimin, kurse metodologjia tregon se si do të përdoren metodat dhe sidomos do të tregojë qartë se si arrihet deri te të dhënat. Konsideroj se nevojitet një sqarim më i madh.

4. Si mund të dimë se cilat metoda duhet të përdoren?

Shpesh harrohet se si bëhet përcaktimi i metodave të një studimi, dhe pikërisht këtu qëndron një prej gabimeve themelore në qasje.

Metodat rrjedhin ose diktohen nga qëllimi i studimit. Me fjalë të tjera, qëllimi figurativisht sugjeron edhe metodat që duhet të përdoren. Si bëhet kjo, ose si mund të kuptohet kjo?

Qëllimi shpreh atë se çfarë do të bëhet ose duhet të arrihet me

studimin në fjalë. Qëllimi, për cilindo që di ta lexojë referencën e tij, sugjeron nënkuptueshëm se cila apo cilat metoda do të përdoren. Nuk mundet të jenë metodat jashtë rrezes që shpreh qëllimi; përkundrazi, ato duhet të burojnë pikërisht nga ai dhe të jenë në funksion të tij.

Për shembull, po qe se qëllimi i një studimi është analiza, atëherë kjo sugjeron se metoda kryesore që duhet të përdoret do të jetë metoda e analizës; po qe se qëllimi i studimit është gjetja e fakteve dhe të dhënave (referencave) në realitet, atëherë kjo sugjeron se metoda kryesore e hulumtimit duhet të jetë metoda empirike; po qe se qëllimi i një studimi është krahasimi midis dy teorive, dukurive, ngjarjeve, sistemeve etj. të ndryshme, atëherë kjo sugjeron se metoda kryesore e hulumtimit duhet të jetë metoda krahasimtare.

Po ashtu, po qe se qëllimi i një studimi është gjetja e përmasës së dukurisë etj., atëherë kjo sugjeron se duhet të përdoret metoda sasiorë; po qe se qëllimi është të kuptohen rastet individuale konkrete të përfshira në një dukuri të caktuar, atëherë kjo sugjeron se duhet të përdoret metoda cilësore. Po qe se qëllimi i një studimi është pikënisja nga një pikëpamje e caktuar teorike (ligj, normë etj.), atëherë kjo sugjeron se duhet të përdoret metoda deduktive etj.

Shpesh dhe zakonisht, këto janë vetëm qasjet kryesore. Një studim mund të ketë nevojë edhe për metoda të tjera që e ndihmojnë studimin. Nevoja e këtyllë sugjeron ndërthurjen e metodave të ndryshme. Për shembull, një studim analitik mund të ketë nevojë për metodën statistikore, ose për metodën përshkruese, për metodën shpjeguese, për metodën normative etj. Sepse nuk mund të realizohet një studim edhe pa ndonjë metodë tjetër, e cila, në këso raste, zakonisht shërben si teknikë, dhe ka një funksion apo rol të kufizuar.

Nga dihet saktësisht se përveç metodës kryesore, ka nevojë edhe për ndonjë metodë tjetër? Përgjigja është se objektivat e shtruara, pyetjet studimore apo/dhe hipotezat mund të shprehin nënkuptueshëm ose hapur nevojën për ndonjë metodë ndihmëse.

Përveç atyre që janë thënë më parë, këtu shfaqet edhe një dimension tjetër i rëndësishëm së formulimit të qartë të objektiveve, pyetjeve studimore dhe hipotezave me qëllimin, se sa më mirë të jenë kalibruar këto

dhe të qëndrojnë në harmoni ndërmjet vete ato do të japin edhe një ndihmesë tjetër shumë të rëndësishme: do të sugjerojnë ndonjë metodë ndihmëse, ndonjë teknikë apo instrument hulumtues.

Për të qenë shkencor të gjithë këta komponentë - tema, qëllimi, objektivi, pyetjet studimore dhe hipotezat si dhe metodat - duhet të jenë të përputhshëm dhe të përplotësojnë njëri-tjetrin, të rrjedhin nga njëri-tjetri dhe të jenë në funksion të njëri-tjetrit, për të realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme studimin.

5. Metodologjia tregon se si do të përdoren metodat dhe se si do të realizohet studimi

Te pjesa ku flitet për metodologjinë është normale të tregohen metodat që do të përdoren, mirëpo kjo është vetëm një pjesë dhe nuk është e tëra. Kur me një periudhë tregohen se cilat metoda do të përdoren, ato, në të vërtetë, vetëm përmenden; gjë që mbase edhe do të mjaftonte këtu, sikurse pastaj, gjatë studimit, në secilin kapitull, të tregohet më gjerësisht se me cilën metodë është realizuar kapitulli në fjalë, por zakonisht nuk bëhet kështu. Prandaj zakonisht aspekti metodologjik është i mangët. Metodologjia kërkon të shprehet qartë se si do të realizohet studimi me metodat e përmendura.

Fjala vjen, nuk mjafton vetëm të thuhet se do të përdoret metoda krahasuese, por duhet treguar si do të përdoret, kur do të përdoret dhe si do të bëhet krahasimi, në cilin kapitull ose në cilat aspekte, raste etj. Po ashtu, nuk mjafton vetëm të thuhet se do të përdoret, fjala vjen, metoda analitike, por duhet të tregohet qartë në cilën pjesë do të përdoret analiza, çka synohet të arrihet me këtë metodë dhe në cilët pjesë/kapituj do të përdoret ose do të bëhet analiza.

Nuk mjafton fjala vjen të thuhet se do të përdoret metoda empirike, normative, statistikore etj., por duhet të tregohet se si do të përdoret secila metodë, në çfarë përmase do të përdoret, si do të jetë ndihmojë studimin, etj.

Kështu duhet të veprohet veç e veç për secilën metodë. Kjo duhet bërë ose në "hyrje", aty te nënkaptulli "metodologjia", ose duhet të tregohet te secili kapitull apo nënkaptull të studimit kur të përdoret njëra prej metodave.

Deri më tash, në të shumtën e

herëve, nuk është bërë kështu. Në një farë mënyre metodologjia konsiderohet sikur të ishte pjesa më e parëndësishme. Kjo qasje duhet të ndryshohet, patjetër, sepse shpërfaq mangësinë shumë serioze të studimit.

6. Duhet metodologë për ta ngritur standardin shkencor

Fakti se thuaja në të gjitha fakultetet dhe programet universitare mësohet lënda e metodologjisë së hulumtimit shkencor tregon se do të duhej të kishte njohuri themelore mbi metodat e ndryshme shkencore dhe atë se si duhet të përdoren ato.

E pra, ka disa arsye se përse, megjithatë, aspekti metodologjik nuk është në nivelin e duhur.

Është e ditur se ligjëruesit e lëndës së metodologjisë nuk janë metodologë. Të jesh i disiplinës nuk domethënë se je edhe metodolog.

Kur një jo-metodolog e ligjëron metodologjinë ai nuk i kushton vëmendjen e duhur pikërisht kësaj lënde, po zakonisht e shpjegon atë që e ka lexuar, ose përvojën nga studimi i vet që ka bërë dhe ka marrë titullin shkencor. Kësisoj, edhe pa dashje, mund të krijojë një perceptim se metodat janë instrumente formale e jo përcaktuese të karakterit shkencor të studimit.

Një metodolog, përkundrazi, fokusohet pikërisht te lënda e metodologjisë duke e zbërthyer atë dhe duke treguar rëndësinë e saj, si qasje që e përcakton nivelin dhe karakterin shkencor, sigurisht të lidhur me objektin e studimit.

Në anën tjetër, kushdo që ka ndjekë lëndën e metodologjisë, megjithatë, do të duhej të kishte marrë disa njohuri elementare, dhe se me rastin e përgatitje së projektit studimor do të ishte e natyrshme t'i freskonin njohuritë e tyre nga metodologjia si nevojë që të realizojnë studimin e tyre.

Ajo që shprehet lidhur metodologjinë në praktikën e tashme të punimeve tregon perceptimin për rolin e saj në realizimin e studimit. E se cili është perceptimi i tyre sot, në pjesën më të madhe, mund të kuptohet po qe se u hidhet një sy punimeve të panumërta të masterit e jo rrallë edhe të temave të doktoratës. Gjithandej shihet çalimi metodologjik, një çalim, për fat të keq, shumë i theksuar dhe që e zbeh shumë bërjen shkencë në shumicën e rasteve të punimeve të ndryshme studi-

more.

Kjo gjendje mbase do të duhej të alarmonte institucionet përkatëse arsimore për nevojën që të bëhet hapi tjetër: të iniciohen programe të studimeve mbi teorinë dhe metodologjinë shkencore, për të përgatitur kadro adekuate, metodologë. Duhet metodologë për të ngritur standardin e bërjes shkencë te ne.

7. Metodologjia tregon në mënyrë transparente bërjen shkencë

Kuptimi i metodologjisë, marrë nga aspekti etimologjik, domethënë shkencë mbi metodat, ose teoria mbi metodat, disiplina e metodave. Kuptimi i kësaj është përcaktimi teorik, shqyrtimi, kritika dhe mendimet për atë se cilat janë rregullat dhe se si funksionon një metodë e cila është vënë në fokus.

Metodologjia, në të vërtetë, është artikulli i metodave se si do të bëhet studimi. Për shembull, në kapitullin "x" do të veprohet saktësisht kështu (tregohet se si konkretisht për çdo punim) për grumbullimin e materialit primar, duke shprehur transparencë dhe objektivitet se si sipas cilës metodë dhe si do të arrihen gjetjet dhe se si do të shfrytëzohen ato si material, prej nga do të nxjerrën të dhënat e caktuara; në kapitullin "y" do të prezantohen gjetjet dhe do të bëhet përshkrimi i tyre; në kapitullin "z" gjetjet do të paraqiten përmes statistikave dhe do të bëhet analiza e tyre; ose se do të bëhet krahasimi midis dy pikëpamjeve, do të shohiten ngjashmëritë dhe kontrastet etj.

Kështu, metodologjia paraqet transparencën e studimit, duke treguar, mbështetur në metodat e përcaktuara, saktësisht se çfarë do të bëhet dhe si do të bëhet në secilin hap të studimit.

Pikërisht për këtë, metodologjia, respektivisht përcaktimi i metodave dhe përcaktimi i qartë se si do të realizohet studimi, kërkon shumë vëmendje e përkushtim, dhe duhet të shprehet me formulime që nuk lënë asgjë të paqartë, asnjë mister e asnjë të panjohur, po gjithçka e tregojnë saktë dhe qartë. Ndaj metodologjia paraqet transparencën procedurale të bërjes shkencë në një punim studimor. (Vijon)

(Autori është prof. ass. dr. dhe ka ligjëruar për shumë vite lëndët Shkrimi akademik dhe Metodologjia e hulumtimit shkencor)

Pompeo: Pheniani ta ndjekë shembullin e Hanoiit

ISLAMABAD, 8 KORRIK - Sekretari Shtetit Mike Pompeo i bëri të dielën thirrje Koresë së Veriut ta ndjekë shembullin e Vietnamit, duke krijuar një marrëdhënie të re me Shtetet e Bashkuara, sikurse bëri Hanoi pesë dekada më parë, pas përfundimit të Luftës së Vietnamit. Kryediplomati amerikan vizitoi të dielën Vietnamin, pas dy ditë

bisedimesh me udhëheqës koreanoveriorë për çar-matosjen bërthamore të Phenianit. Ai tha se marrëdhëniet e normalizuara 23-vjeçare mes Shteteve të Bashkuara dhe Vietnamit duhet të shërbejnë si një provë për udhëheqësin koreanoverior Kim Jong Un, se ShBA-ja ka aftësinë për të krijuar marrëd-

hënie të reja me një vend që dikur kanë pasur marrëdhënie armiqësore.

Pompeo nuk u kushtoi rëndësi akuzave të Koresë së Veriut, se Shtetet e Bashkuara kishin ofruar "kërkesa prej gangsterësh", që Pheniani t'i japë fund programit bërthamor dhe se mënyra se si u zhvilluan bisedimet mes të dy vendeve

ishite "për të ardhur keq". "Nëse këto kërkesa janë prej gangsterësh, atëherë bota qenka një gangster", tha sekretari i Shtetit Pompeo, ndërsa përmendi faktin se Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka kërkuar shumë herë që Pheniani të heqë dorë nga armët bërthamore dhe t'i japë fund programit të raketave balistike. Ai përsëriti premtimin



e presidentit Donald Trump për fuqizimin e ekonomisë së Koresë së Veriut, pasi të marrë garanci për nga Kim se po u jep fund armëve bërthamore.

Samiti i NATO-s, pritje me ankth e Donald Trumpit

Kanadaja dhe partnerët evropianë e presin me frikë Trumpin në kryeqytetin belg, ku është e qartë se presidenti amerikan nuk do të druhet ta hapë gojën për faturat e mbrojtjes. Edhe pse evropianët kanë nisur të shpenzojnë më shumë për ushtrinë, e kjo është e dukshme tashmë, shefi i Shtëpisë së Bardhë sërish nuk është i kënaqur

Berlin, 8 korrik - NATO-ja shpreson që anëtari i saj më i rëndësishëm, ShBA-ja, të mos shkaktojë dëme të mëdha në Samitin e Brukselit të mërkurën. "Deri në këtë pikë kanë arritur marrëdhëniet transatlantike", thotë analisti Bernd Riegert, i cituar nga "Deutsche Welle". Kanadaja dhe partnerët evropianë e presin me frikë Trumpin në kryeqytetin belg, ku është e qartë se presidenti amerikan nuk do të druhet të hapë gojën për faturat e mbrojtjes. Edhe pse evropianët kanë nisur të shpenzojnë më shumë për ushtrinë, e kjo është e dukshme tashmë, shefi i Shtëpisë së

Bardhë sërish nuk është i kënaqur.

Zemërat e tij i drejtohet më së shumti Angela Merkelit. "Gjermania, argumenton Trumpi, është vendi kryesor në Bashkimin Evropian dhe nuk i përmbush detyrimet e veta, duke u kthyer në një shembull të keq edhe për të tjerët". Gjermanët bëjnë pazare në fushën e energjisë me rusët dhe ne amerikanët jemi budallenjtë që paguajmë çdo gjë", tha Trumpi.

Pjesë e përpjekjeve të tij për ta ndryshuar situatën ishte edhe paralajmërimi për një tërheqje të mundshme të trupave



amerikane nga Gjermania. Sipas Riegert, të ardhmen e marrëdhënieve brenda NATO-s e ka skicuar Ministria e Mbrojtjes në Poloni. Polakët

kanë ofruar dy miliardë në vit për stacionimin e trupave amerikane. Ky model mund t'i pëlqejë Trumpit. Gjithë çfarë u ka mbetur anëtarëve të tjerë të

Aleancës është të shpresojnë se presidenti i fuqisë më të rëndësishme ushtarake do ta njohë detyrimin për ndihmë brenda këtij organizmi.

Kryeministri Yildirim kandidat për kryetar të Parlamentit turk

ANKARA, 8 KORRIK - Grupi parlamentar i Partisë AK i ka dorëzuar Kryesisë së Kuvendit propozimin për kandidaturën e kryeministrit të Turqisë, Binali Yıldırım për kryetar të Kuvendit të Madh Popullor të Turqisë (TBMM), raporton Anadolu Agency.

Pas zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të 24 qershorit në Turqi, të dielën deputetët e zgjedhur zhvilluan ceremoninë e betimit.

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë AK, Naci Bostancı dhe nënkryetarët e grupit parlamentar të kësaj partie i dorëzuan Kryesisë së Kuvendit kandidaturën e kryeministrit Yıldırım për kryetar të Parlamentit të Turqisë (TBMM).

Yıldırım duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve për kandidimin e tij për kryetar të Parlamentit u



shpreh se shpresonte që ky vendim të ishte në të mirë të atdheut dhe të popullit.

Pas pyetjes së drejtuar nëse është kandidati i parë për kryetar të Parlamentit, Yıldırım tha se mund të dalin edhe kandidatë të tjerë.

Yıldırım, kryeministri i fundit i Turqisë po ushtron ditët e fundit në këtë detyrë, pasi vendi zyrtarisht kaloi drejt një sistemi presidencial të qeverisjes me fitoren në zgjedhje të presidentit, Recep Tayyip Erdogan.

Në Turqi largohen nga puna 18 000 shërbyes civilë

ANKARA, 8 KORRIK - Turqia ka lëshuar një dekret që përjashton 18 000 shërbyes civilë, gjysma e të cilëve ishin pjesëtarë të forcave policore, mbi dyshimet se ky grup punon kundër sigurisë kombëtare.

Dekreti i lëshuar më 8 korrik, mbylli 12 asociacioni rreth vendit si dhe një gazetë e një televizion lokal. Kjo lëvizje ndodh në prag të dyvjetorit të tentim grusht-shtetit. Qeveria turke kishte fajësuar klerikun mysliman me bazë në Amerikë, Fetullah Gylen, për tentim grusht-shteti, ku mbetën të



vrarë 250 persona. Gylen kishte mohuar përfshirjen në grusht-shtet. Autoritetet turke kanë ndaluar dhjetëra-mija njerëz, të dyshuar për përfshirje dhe

mbështetje të Gylenit. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut, duke përfshirë Amnesty International, kanë kritikuar këtë vendim.

Rritet numri i viktimave në Japoni pas vërshimeve të mëdha

TOKIO, 8 KORRIK - Kërkimet kanë vazhduar të dielën mbrëma për viktimat e vërshimeve të mëdha në jug të Japonisë për ditën e tretë me radhë. Qeveria ka njoftuar se 48 persona kanë

vdekur, ndërsa 28 të tjerë dyshohet se nuk kanë mbijetuar. Zëdhënësi i Qeverisë ka deklaruar se 92 persona janë zhdukur, sidomos në zonën Hiroshima.

Më shumë se 100 raportime të incidenteve janë lajmëruar. Më shumë se 40 helikopterë kanë dalë në kërkim shpëtim. "Shpëtimi është në garë me kohën", deklaroi kryeministri

japonez, Shinzo Abe. Agjencia Meteorologjike e Japonisë ka bërë me dije se tri orë të reshjeve kanë akumuluar 26.3 centimetra ujë, më të lartat që nga viti 1976.



Pasthënie, përkitazi rreth romanit "Udhëtimi i Gertit" të shkrimtarit Murat Gashit


QYTETI I FLIJIMIT PËR LIRI

Mr. sc. Fatmir HALIMI

Romani "Udhëtimi i Gertit" i shkrimtarit tonë tashmë të dëshmuar Murat Gashit ka një histori të rrëfimit dhe të shkrimit. Autori e kishte filluar shkrimin një apo dy vjet para nisjes së luftës në Kosovë për t'i vazhduar disa pjesë edhe pas luftës, kurse dritën e botimit e sheh tek tash nga shtëpia botuese "ProkultPress", Prishtinë. Shkrimtari Gashi, qysh në hyrje të romanit e parapërgatit lexuesin se ngjarjet që zhvillohen aty nuk kanë një rrjedhë të njëtrajtshme dhe klasike, po ato do të rrëfehen në mënyra të ndryshme varësisht nga gjuha komunikuese e personazheve dhe varësisht nga toposi në të cilin bartet ngjarja. Ngjarja zhvillohet në qytetin simbolik "Muranë", që mund t'i takojë kohës universale, pra secilës kohë, dhe themi se merr karakter historik, por edhe aktual. Qyteti Muranë sipas përshkrimeve që i bën personazhi kryesor Gerti, një djalë i ri, një ekonomist i zoti, që babai i tij udhëheq një firmë të madhe në Francë, të jetës së njerëzve, të ndërtimit urbanistik si të rrugit-

cave të ngushta me gurëkatror, shtëpive, lagjeve etj. mund të jetë Prizreni, Prishtina, apo edhe secili qytet i para dy dekadave të Kosovës. Ndërsa tema që zhvillohet është lufta për liri, flijimi për liri dhe jo rastësisht tërë romanin mund ta titullonim edhe si: Qyteti i flijimit për liri. Temë kjo që në vete përmbledh preokupimet e mëhershme tematike edhe të shkrimtarëve të mëdhenj të letërsisë sonë si të R. Qosjes, I. Kadare, Z. Rrahmanit e shumë të tjerëve. Kurse, për nga rrëfimi i tekstit e po ashtu edhe për nga ndërtimi dhe realizimi i tij si tekst është postmodern, që me sukses autori i shfrytëzon të gjitha elementet dhe kategoritë stilistike si intertekstualitetin, retrospektiven, dokumentaritetin, paralelizmin tematik e të tjera.

Në fillim të romanit shtrohet teorikisht dhe praktikisht kërkesa e personazhit kryesor Gerti për të udhëtuar nga Franca për në qytetin e Muranës, konkretisht në vendlindjen e të dashurës së tij Dardanës. Teorikisht paraqitet njohja e qytetit nga një i huaj përmes të dashurës së tij shqiptare Dardanës, si dhe



mbledhja e informative nga librat e shumtë në gjuhën frënge për zakonet, traditat, moralin e njerëzve, si dhe për lashtësinë e ndërtimit të qytetit, fortifikimin e tij, ku aty tregohen legjenda të ndryshme për ndërtimin e qytetit Muranë. Kurse praktikisht paraqitet realizimi i kërkesës së Gertit, i cili arrin në Kosovë, konkretisht në Muranë, ku ky qyteti është në prag të luftës. Këtu jeta e shqiptarëve është në zgrip apo në shkallën e fundit të robërimit dhe të nënshtrimit nga okupatori, pasi që lufta dhe flijimi për të fituar lirinë e qytetit të tyre kishte marrë jetët e shumë njerëzve, populli dhe udhëheqësit e tij kishin mobilizuar burrat që duhej të luftonin për liri. Kurse Gerti si një i huaj, por që e donte shumë lirinë e cilit do popull të robëruar, para vetë merr detyra të rënda si për t'i njoftuar organizatat e ndryshme evropiane për gjendjen e rëndë dhe përmes shkrimeve që i dërgonte në gazeta t'i informonte se në qytetin e Muranës po zhvillohej një luftë e për liri. Ai përveç kësaj si detyrë e merr edhe një punë tjetër, atë të arkeologut që të hulumtoj nëpër varreza,

nëpër themele të mureve të vjetra të kalasë, duke gërmuar në to që të gjejë sa më shumë eshtra, të cilat do t'i përdorte si dëshmi për të vërtetuar lashtësinë ilire të popullit, por edhe të ndërtimit të qytetit Muranë. Gerti për t'i arritur këto do të bashkëpunojë me shqiptarët e devotshëm dhe patriotë si Dilin, Profesorin, Gëzimin dhe së fundi edhe me Dardanën, e cila pas një kohe vjen edhe ajo në Kosovë. Gërmimi ishte punë e rrezikshme gjë që bie në sy edhe të forcave okupatore. Ishte gjendje lufte dhe në betejën që zhvillohet në fshatin Rrafshnaltë, Gerti fal miqve të tij dhe ushtarëve liridashës shpëton mrekullisht. Por okupatori vihet në ndjekje të tij dhe në fund e vret heroin tonë të romanit, pra Gertin. Nga ky përshkrim i fabulës në vija të trasha vërehet se romani "Udhëtimi i Gertit" na i paraqet dy botë diametralisht të kundërta atë të okupatorit ose të pushtuesit dhe atë të mbrojtësit dhe të luftëtarëve të lirisë. Këto kundërshtitë nuk janë vetëm në këtë pikë, por ato manifestohen në të gjitha poret e jetës si në mentalitet, në sjellje të përdit-

shmërisë, në gjuhë, në zakone e të tjera. Romani "Udhëtimi i Gertit" sa është histori e rrëfimit të sakrificave të shqiptarëve për liri, po aq është një histori e një të huaji për t'i mbrojt dhe për t'i përkrahë përpjekjet e një populli të vogël për tu çliruar nga armiku si dhe për të dëshmuar të vërtetën historike të shqiptarëve ndër shekuj. Me këtë rast duhet të cekim se krejt në fund të romanit, pra në epilog mësojmë se personazhi hero Gerti ka prejardhje shqiptare dhe ndoshta është edhe kjo një arsye përveç dashurisë së madhe që kishte për Dardanën të vizitojë Kosovën dhe të zbulojë të vërtetën.

Përfundim

Pas këtij shqyrtimi teorik të diskutimit letrar mbi romanin "Udhëtimi i Gertit" i shkrimtarit Murat Gashit, vijmë në disa përfundime.

Së pari, është roman, që ngreh vazhdimisht idenë e luftës për liri dhe çlirim kombëtar. Ky roman na vijnë si perlë në letërsinë tonë, i cili na lë pa frymëmarrje nga kureshtja se ç'do të ngjet në faqet pasuese të tyre.

Së dyti, romani "Udhëtimi i Gertit", është një ndër veprat më të arrira artistikisht të autorit, është një prej veprave më të mëdha të letërsisë shqipe të krijuara në këto dy dekadat e fundit, apo në këtë milenium të ri dhe është një prej veprave që diskutit kritik i ofron mundësi të mëdha interpretimi.


Dhe së fundi mund të them se me këtë studim nuk u përmbyll shqyrtimi analitik mbi romanin "Udhëtimi i Gertit", por vetëm u hap një dritare për studime dhe interpretime të mëtejshme në diskutimin letrar nga kritikët tanë.



Berati, 10 vjet në UNESCO

Berat, 8 korrik - Qyteti i Beratit të dielën ka festuar 10-vjetorin e hyrjes në UNESCO. Përfshirja e qytetit të Beratit në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s u bë më 8 korrik të vitit 2008, në sesionin e 32-të të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, që u zhvillua në Quebec të Kanadasë. Për hyrjen e këtij qyteti të lashtë, ku qytetërimi nis që prej shekullit të VII para erës së re, votuan unanimisht 189 përfaqësuesit

botërorë. Mes zonave më të vizitueshme nga turistët e huaj dhe ata vendës veçohet ajo e kalasë 2.500-vjeçare, por nuk mbetet pa rënë në vëmendjen e tyre edhe arkitektura e veçantë e shtëpive dhe kishave të pranishme në qytet. Sidomos prej vitit 2008, pas suksesit të përfshirjes në UNESCO, Berati është bërë pjesë e thuasj të gjitha guidave turistike shqiptare e të huaja, që sjellin vizitorë në vendin tonë përgjatë gjithë vitit.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

FRANCE - BELGIUM

GG

CROATIA - ENGLAND

GG

FIGUEIRENSE - OESTE

1

Rexha fitoi titullin dhe Kupën, por nuk luajti në Evropë

Sulmuesi Kastriot Rexha është ndër të paktët futbollistë në Kosovë që ka arritur të dalë fitues i Kupës dhe i titullit të kampiones, por që nuk është paraqitur në garat evropiane. Ai ka thënë të dielën për "Epokën e re" se ndihet krenar që ka kontribuar në suksesin e Besës, më pas edhe të Dritës, derisa një gjë të tillë synon ta bëjë edhe në skuadrën e Feronikelit

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kastriot Rexha është një nga lojtarët më të mirë në vitet e fundit në futbollin e Kosovës, por jo edhe ndër ata që kanë shumë fat. Sulmuesi shtatë nga kryeqyteti arriti që në dy edicionet e fundit të shijojë dy trofetë më të vlefshëm në futbollin e Kosovës, titullin dhe Kupën, të cilët u mundësojnë skuadrave fituese daljen në garat ndërkombëtare, por Rexha në të dyja rastet dështoi të paraqitet në Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Evropës. Në edicionin 2016/2017, sulmuesi ishte pjesë e Besës nga Peja me të cilën arriti të dalë fitues i Kupës, por për shkak të moslicencimit të skuadrës pejane në garat e Ligës së Evropës u paraqit nënkampionia e Kosovës, Prishtina.

"Ishte një vit i suksesshëm për Besën në atë edicion, pasi gjatë gjithë edicionit nga kanë përcjellë shumë probleme. Fatkeqësisht, klubi nuk arriti të licencohet dhe nuk patëm të drejtën të luajmë në Evropë", ka thënë Rexha për rastin e parë të dështimit që të paraqitet dhe të shënojë gol në arenën ndërkombëtare. Më pas, Rexha u transferua te Drita dhe pas një edicioni të shkëlqyeshëm arriti ta fitojë titullin e kampiones, por prapë ai nuk u paraqit në Evropë. Këtë herë dështoi marrëveshja për ta vazhduar kontratën me skuadrën nga Gjilani dhe përfundimisht vendosi të transferohet në Drenas te skuadra e Feronikelit. "Jam shumë i lumtur që kam kontribuar në suksesin e madh të skuadrës së Dritës. Kemi punuar të gjithë nga fillimi e deri në fund për ta arritur titullin e kampionit, kurse me këtë rast skuadra e fitoi të

drejtën e pjesëmarrjes në garat e Ligës së Kampionëve, por unë nuk arrita marrëveshje të re me drejtuesit e klubit", ka deklaruar ai.

Drita është paraqitur mirë në dy ndeshjet e para dhe tash do të luajë ndaj kampiones së Suedisë, Malmos. Rexha i ka uruar suksese edhe në këtë ndeshje ish-skuadrës së vet. "Drita është paraqitur mirë dhe tash e ka një ndeshje të vështirë para vetes. Besoj se do të ketë një paraqitje të mirë edhe kësaj radhe. Paraqitja e Dritës dhe Prishtinës në këtë edicion në garat ndërkombëtare është mjaft pozitive për futbollin e Kosovës", ka shtuar ai. Sulmuesi Kastriot Rexha karrierën futbolistike do ta vazhdojë në skuadrën e Feronikelit. Ai e pranoi ofertën e kësaj skuadre, ani pse ofertat në drejtim të tij ishin nga shumica e klubeve elitare të Kosovës.

SHKURT

Sevilla interesohet për Xhakën

Futbollisti shqiptar Taulant Xhaka mund t'i bashkohet skuadrës së Sevillës në këtë afat kalimtar. Në fakt, Arsenali është duke e kërkuar mesfushorin e Sevillas, Steven N'Zonzin dhe në rast të kalimit të francezit në skuadrën angleze, atëherë mesfushori i Bazelit dhe Shqipërisë, Taulant Xhaka, do t'i bashkohet Sevillas.

Daliç kërkon fitore ndaj Anglisë

Pas suksesit në çerekfinale ndaj Rusisë, Zlatko Daliç kërkon edhe një tjetër sukses ndaj Anglisë në gjysmëfinale. "Ne gjithmonë e kemi ditur rrugën e vështirë, por duhet të luftojmë deri në fund. Luftë, dhimbje dhe përpjekje, e ky është shpërblimi. Kroacia është në gjysmëfinale. Ishte diçka e jashtëzakonshme. Ne e dimë se si luajnë rusët dhe për më tepër ishte një ndeshje kundër 50 mijë tifozëve. Do të ndieja keqardhje të largohesha nga Rusia pa e parë Moskën", ka thënë Daliç.

Deschamps, Mbappes: Botërori ende nuk ka përfunduar

Trajneri i Francës, Didier Deschamps, kërkon nga sulmuesi Kylian Mbappe të shënojë sa më shumë dhe të mos kënaqet me pak. Deschamps ia ka rikujtuar 19-vjeçarit se Botërori ende nuk ka përfunduar. "Mbappe nuk duhet të kënaqet me atë që ka bërë dhe atë që ka arritur deri më tani. Botërori për atë dhe për Francën nuk ka përfunduar ende, ndaj duhet të vazhdojë me këtë ritëm edhe në ndeshjet e tjera. Ai mund të fluturojë më lart. E dimë moshën e tij të re, ndaj ka nevojë të mësojë nga veteranët. I kam thënë të jetë i kujdesshëm në fushë, t'i shfrytëzojë mundësitë që ka, të mos nervozohet, pasi e ka një të verdhë dhe kemi nevojë për të në çdo ndeshje", ka thënë Deschamps.

Vetteli triumfoi në Silverstone

LONDËR, 8 KORRIK - Sebastian Vetteli fitoi garën e Çmimit të Madh të Britanisë në Formula 1, duke triumfuar në pistën e Silverstones, në fund të një

gare me shumë emocione e rivalitet, vendosur në xhirot e fundit të saj. Piloti gjerman i Ferrarit parakaloi pesë xhiro nga fundit finlandezin Valtteri

Bottas, që deri në ato çaste kryesonte garën. Hamiltoni u rendit i dyti me makinën Mercedes, një garë që nisi keq për të, por që rikuperoi pas

futjes në pistë dy herë të makinës në sigurisë. Në podium u ngjit edhe Kimi Raikkoneni, i treti me makinën tjetër Ferrari.



Parkeri largohet nga San Antonio pas 17 vjetësh

San Antonio, 8 korrik - Tony Parker ka vendosur të largohet nga San Antonio Spurs pas 17 vjetësh. Ylli francez që prej se shkeli në NBA u paraqit në fanellën e klubit teksan. Me San Antonion, Parkeri ka fituar katër herë

titullin e kampionit të NBA-së, që është një arritje e jashtëzakonshme për një lojtar evropian. Parkeri aventurën do ta vazhdojë te Charlotte Hornets, klub i cili drejtohet nga legjenda Michael Jordan. Parkeri do t'i fitojë 10 milionë

dollarë në dy vjetët e ardhshëm dhe largimi i tij shihet si vazhdimi i përfundimit të epokës së artë të San Antonios, ku vetëm Manu Ginobili ka mbetur nga tandemi i famshëm i tyre me Tim Duncan.



Në gjysmëfinale mund të ndodhë gjithçka!

MOSKË, 8 KORRIK - Anglia, Belgjika, Franca dhe Kroacia, sipas rendit alfabetik, janë skuadrat e mbetura që do të tentojnë ta kapin fillimisht finalen, më pas të ngrenë trofeun e Kupës së Botës që po zhvillohet në Rusi, epilogu i së cilës do të mbyllet mbrëmjen e 15 korrikut në Moskë. Janë pikërisht këto katër kombëtare, që për shkak të ecurisë në turneun e sivjetshëm, konsiderohen si katër më të fortat e botës, por vetëm njëra prej tyre do të bëjë të vetin trofeun dhe futjen në librat e historisë. Dikush mund ta ketë mbiquajtur një "minievropian", por është e padrejtë për sa kohë që kemi parë të eliminohen nga verdiktet e fushave të blerta, mes të tjerave, edhe skuadrat amerikano-latine si Argjentina, Brazili, Kolumbia dhe Uruguai. Gjithsesi, një të vërtetë e ka sanksionuar edhe ky turne: deri më tani ka bërë përpara më e mira që mund të ofrojë futbollit, si një lojë kolektive e duke lënë mënjanë individët. Thjesht dhe qartë, s'ka Messi, por Griezmann dhe Mbappe; s'ka Neymar, por De Bruyne dhe Hazard; sikurse u është mohuar mundësia për të shkuar drejt trofeut Cristiano Ronaldos, Cavanit, Suarezit, Di Marias. Tashmë është momenti i së vërtetës për lojtarë si Kane, Alli, Modriq dhe Rakitiq, të cilët premtojnë gjithashtu spektakël. Botërori do të ndalet sërish për dy ditë, për të rifilluar të martën në Shën Pjetërburg, ku pritet të zbrisin dy skuadra me teknikë dhe shpejtësi të llahtarshme. Franca, nga njëri krah, që vjen si pretendente prej fillimit, e Belgjika nga krahun tjetër, që duket e gatshme më në fund t'i bëjë realitet



ëndrrat e një brezi të tërë. Duetet e drejtpërdrejta në të kaluarën flasin në favor të "gjelave" francezë, të cilët, mes Botërorëve dhe Evropianëve, nuk kanë humbur kurrë përballë "djajve të kuq" por, faktikisht, Hazardi me shokë treguan edhe ndaj Brazilit se kanë ardhur në Rusi për t'i shkuar deri në fund këtij turneu. Sulmet e të dyja skuadrave janë të frikshme: Mbappe dhe Griezmann do të sfidojnë Lukaku, Hazard dhe De Bruyne, por sfida e vërtetë do të zhvillohet në mesfushë, aty ku Franca gëzon një avantazh ekuilibritet krahasuar me skuadrën e drejtuar nga Martinez. Kante dhe Pogba janë një mur i pakalueshëm, fizikisht dhe teknikisht, ndërsa në aspektin mbrojtës, Belgjika mund t'i falet sërish një dite të mirë të Courtois, pa harruar se përballë kanë një tjetër portier të shkëlqyer si Lloris. Sfida tjetër zhvillohet mes dy kombëtareve që konsiderohen si "outsider". Është një sfidë tipike mes mesfushës së hekurt të kroatëve dhe freskisë së Anglisë, e për më tepër aty ku nuk mund të veçosh një emër apo një

çelës suksesi. Kroacia, sa i përket organikës, është një prej skuadrave më të forta të Botërorit, por ka hasur shumë vështirësi si ndaj Danimarkës, ashtu edhe ndaj Rusisë, duke siguruar kalimin e tureve vetëm falë penalltive. Ndërsa Anglia është e paparashikueshme, sikurse edhe lojtarët sulmues të "Tre luanëve". Diferencën pritet ta bëjnë vetëm detajet, ndoshta edhe zgjedhjet që mund të bëjnë trajnerët respektivë. Kroacia e udhëhequr nga Rakitiq dhe Modriq ka arritur tashmë objektivin, përsëritjen e suksesit historik të vitit 1998, ndërsa anglezët mungonin në një gjysmëfinale prej Botërorit të vitit 1990, tashmë me një skuadër tejet të re nën drejtimin e Southgate, duke ndezur kështu entuziazmin e të gjithëve, përfshirë edhe tifozët specialë brenda "Buckingham Palace". Gjithsesi, një paralajmërim për "ta shpëtuar Mbretëreshën", është: shmangni 11-metërshat! Kroacia di fare mirë se si fitohet nga gjuajtjet e penalltive dhe këtë e ka treguar, ndërsa Anglia sapo ka thyer një tabu të gjatë ndër vite.

Xhaka: 50-60 % e skuadrës është me dy nënshtetësi

CYRIH, 8 KORRIK - Fitorja e Zvicrës kundër Serbisë ngjalli një debat të vjetër. Kjo ndodhi jo vetëm në shtetin zviceran, por edhe më gjerë. Gjithë debati u krijua për shkak se dy golashënuesit e ndeshjes, Xhaka dhe Shaqiri, festuan me shqiponjë. Disa ditë më parë sekretari i përgjithshëm i Federatës Zvicerane u shpreh se nuk duhet të ketë futbollistë në kombëtare me 2 nënshtetësi. Megjithatë, Xhaka nuk ka qëndruar duarkryq dhe i është kundërpërgjigjur kësaj deklarate pasi, siç dihet, ai është me origjinë nga Kosova. "Kur po luanim në Rusi dhe ishte problemi i shqiponjës, Aleks i erdhi duke na thënë të mos shqetësohemi, pasi do ta kishim mbështetjen e tij në çdo moment, ndërsa pas eliminimit, i njëjti person thotë se lojtarët me dy nënshtetësi nuk duhet të luajnë". "Deklarata e tij vjen drejtpërdrejt tek unë dhe te futbollistët e tjerë si unë.



Ai kishte të drejtë të thotë kështu, nëse unë apo të tjerët nuk do të jepnim maksimumin, por ne vijmë nga Rusia me vetëm një humbje", ka deklaruar Xhaka. Por, ai sqaron edhe situatën e të tjerëve në kombëtare. "Ne të gjithë jemi zviceranë dhe luajmë për kombëtaren e Zvicrës, pasi jemi pa dyshim mirënjohës për atë që Zvicra na ka dhënë. 50-60 % e

skuadrës është me dy nënshtetësi, pasi familja ime është nga Kosova, Embolo nga Kameruni, Akanzhi nga Nigeria e Rodriguez nga Kili. Gjithashtu, edhe Petkoviçi është me dy nënshtetësi, por ne derdhim djersë dhe gjak për skuadrën kombëtare. Deklaratat e tij kanë sjellë shumë pakënaqësi dhe zhgënjim te ne", përfundoi Xhaka

SHKURT

Kahn: Lowi gaboi që ftoi Neuerin

Ish-portieri i Gjermanisë, Oliver Kahn, ka thënë se trajneri Joachim Low gaboi me marrjen e Manuel Neuerit në Kupën e Botës "Rusi 2018". "Grumbullimi i Neuerit nuk duhet të ndodhte, këtë e kam shprehur edhe para se të fillonte Kampionati Botëror. Nuk e di se pse trajneri vendosi të përdorë kriteret e tjera për të. Ai nuk luante prej shumë kohësh dhe në portë mund të luante Ter Stegen", ka thënë Kahn.

Modriq: Ronaldo nuk largohet nga Reali

Kroacia është kualifikuar në gjysmëfinale të Kupës së Botës "Rusi 2018", por Luka Modriq ka befasuar të gjithë opinionin, duke thënë se Cristiano Ronaldo nuk do të largohet nga Real Madridi. "Të shohim se çfarë do të ndodhë, por personalisht besoj se Cristiano nuk do të largohet nga Reali. Do të më pëlqente shumë që ai të qëndronte, pasi është lojtari më i mirë në botë", ka thënë Modriq. Ndryshe, Ronaldo që disa ditë është duke u lidhur me një transferim në skuadrën kampione të Italisë, Juventus.

PSG-ja, 100 milionë dhe Rabiotin për Kanten

Kampionia e Francës, Paris Saint Germain, po planifikon transferimin e N'Golo Kantës. Sipas medieve franceze, Naser Al-Khelaifi është gati t'i ofrojë Chelsea një shumë prej 100 milionë eurosh dhe si pjesë të marrëveshjes të përfshirë edhe mesfushorin Adrien Rabiot. Aktualisht Kante është i përfshirë me Francën në Botëror dhe pas përfundimit të këtij eventimi do të dihet edhe e ardhmja e yllit francez.

Hierro largohet nga Spanja

Fernando Hierro nuk do të vazhdojë të jetë në postin e përzgjedhës të Spanjës pas eliminimit nga Kampionati Botëror "Rusia 2018". Lajmin e ka konfirmuar Federata e Futbollit e Spanjës. "Pas shumë kilometrave të përbashkët, Federata e Spanjës dhe Fernando Hierro kanë ndarë rrugët me përfundimin e Kampionatit Botëror. Trajneri ka refuzuar të kthehet në pozitën e drejtorit sportiv për të kërkuar sfida të reja profesionale", ka njoftuar Federata Spanjolle. Hierro u bë përzgjedhës një ditë pasi Julen Lopetegui u shkarkua, pak para nisjes së Botërorit.

Reali ofron Balen për Lukakun

Real Madrid po mendon t'i ofrojë Gareth Bale Manchester United në këmbim të Romelo Lukakut. Uellsiani ka lënë të kuptohet se ka dëshirë të largohet nga madrilenët pas finales së Ligës së Kampionëve të luajtur dhe fituar kundër Liverpoolit sezonin e kaluar. "Djajtë e Kuq" janë mes skuadrave që duan t'i sigurojnë shërbimet e Bales për sezonin e ardhshëm, ashtu si ish-klubi i tij, Tottenham. Sipas shtypit spanjoll, Lukaku është përzgjedhur si zëvendësuesi i mundshëm i Cristiano Ronaldos. Sipas "Don Balon", media e famshme spanjolle për lajmet e bujshme që publikon, madrilenët kanë ndërmend ta shfrytëzojnë interesin e Unitedit për Balen.



**Republika e Kosovës – Republika Kosovo –
Republic of Kosovo**

Qeveria – Vlada – Government

Zyra e Kryeministrit – Kancelarija premijera – Office of The Prime Minister

Zyra e Komisionerit për Gjuhët – Kancelarija poverenika za jezike

Office of the Language Commissioner

Prishtinë, 09.07.2018

THIRRJE PUBLIKE

**për ofrimin e mbështetjes financiare publike të
projekteve/programeve të OJQ-ve në promovimin dhe
mbrojtjen e të drejtave gjuhësore**

1. Zyra e Komisionerit për gjuhët iu bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës kanë aktivitete **fushën e të drejtave gjuhësore** të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në **promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore**.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:

Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave gjuhësore dhe forcimi i partneritetit dhe bashkëpunimit të Organizatave Jo-Qeveritare me aktorët e tjerë, në veçanti me institucionet qeveritare

Monitorimi i zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nëpër institucionet nën jurisdikcionin e ZKJ-së dhe mbështetja e institucioneve në përputhshmërinë me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Mbrojtja e gjuhëve të pakicave, gjuha e të cilëve nuk ka statusin e gjuhëve zyrtare dhe promovimi i mësimin të gjuhëve të rrethit.

Organizatave jo-qeveritare mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në **promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore** përmes aktiviteteve si më poshtë:

Aktivitete që synojnë avancimin e politikave qeveritare në fushën e mbrojtjes së të drejtave gjuhësore;

Aktivitete monitorimi dhe trajnimi të stafit të institucioneve lokale dhe qendrore për përmirësimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të zyrtarëve komunalë në mësimin e gjuhëve zyrtare;

Aktivitetet që synojnë nxitjen e komunikimit të OJQ-ve me publikun dhe institucionet, me fokus në informimin e publikut për të drejtat gjuhësore;

Aktivitete që synojnë adresimin e problemeve specifike të të drejtave gjuhësore dhe shkeljes së tyre;

Aktivitete në avancimin e politikave gjuhësore në sektorë të caktuar të politikave prioritare qeveritare duke përfshirë, arsimin, politikat sociale, shëndetësinë, drejtësinë, shërbimet publike etj.

Përdorimi i teknologjive të reja të rrjeteve sociale që ndihmojnë zbatimin e Ligjit.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **49520 euro**.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të ndahet për çdo projekt individual është **600 euro** ndërsa shuma maksimale për një projekt është **15.000 euro**.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën **27.07. 2018, deri në orën 16h**.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti me dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrjeje, por vetëm me një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është deri në 12 muaj. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës së paku *një vit* para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë

se programi i tyre i punës përmbanë aktivitete në fushën e të drejtave të gjuhëve. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja fituese duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për aplikuesit janë në dispozicion në faqen e internetit të Zyres së Komisionerit për gjuhët (web faqja: <http://www.komisioneri-ks.org> dhe www.kryeministri-ks.net)


Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

**ZYRA E KRYEMINISTRIT/ZYRA E KOMISIONERIT PËR GJUHËT
NDËRTESA E QEVERISË; ZYRA 605A,
SHESHI "NËNA TEREZE"
10000, PRISHTINË**

Në "**Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike**", janë të detajuara: Procesi i pranimit, hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve; Kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave; si dhe trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes.

Do të merren parasysh për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, si dhe janë dërguar me postë brenda afatit të cekur në thirrje dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara në thirrjen publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: zkgj.kpj@gmail.com dhe info-zkgj-kpj@rks-gov.net



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi


Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit – Kancelarija premijera – Office of The Prime Minister
Zyra e Komisionerit për Gjuhët – Kancelarija poverenika za jezike
Office of the Language Commissioner
Priština
09.07.2018. godine
JAVNI POZIV
**za ponudu javne finansijske podrške projektima /
programima NVO-a u
Promociji i zaštiti jezičkih prava.**

1. Kancelarija poverenika za jezike poziva sve nevladine organizacije registrovane u Republici Kosovo, koje u svom portfoliju imaju aktivnosti za **zaštitu jezičkih prava**, da konkurišu za finansijsku podršku projektima koji doprinose u *Promociji i zaštiti jezičkih prava*.

2. NVO u skladu sa ovim javnim pozivom mogu da apliciraju sa projektima/programima iz sledećih prioritetnih oblasti:

Promocija i zaštita jezičkih prava i jačanje partnerstva i saradnje sa nevladinim organizacijama i drugim akterima, sa vladinim institucijama.

Nadgledanje sprovođenja Zakona o upotrebi jezika u institucijama koje su pod nadležnošću KPJ i podrška institucijama radi usaglašenosti sa Zakonom o upotrebi jezika.

Zaštita jezika zajednica čiji jezik nema status službenog jezika i

Promocija učenja jezika okruženja;

3. Nevladine organizacije mogu da konkurišu sa projektima da doprinesu **promociji i zaštiti jezičkih prava** na osnovu dole navedenih aktivnosti:

- Aktivnosti u cilju jačanja vladine politike iz oblasti zaštite jezičkih prava;
- Aktivnosti u cilju nadgledanja i obuke osoblja lokalnih i centralnih institucija kao i poboljšanje razvoja znanja i veština opštinskih službenika u učenju službenih jezika;
- Aktivnosti u cilju promocije komunikacije NVO sa javnošću i instiucijama, sa posebnim akcentom na informisanje javnosti o jezičkim pravima;
- Aktivnosti u cilju rešavanja specifičnih problema u oblasti jezičkih prava i kršenja istih;
- Aktivnosti u promociji jezičke politike u određenim sektorima vladine prioritetne politike, uključujući obrazovanje, socijalnu politiku, zdravstvo, pravo, javne usluge idr.;
- Korišćenje novih tehnologija i društvenih mreža koje pomažu primenu Zakona;

4. Ukupna planirana vrednost poziva iznosi **49.520 evra**.

Minimalni iznos finansijske podrške koji se može dodeliti za svaki individualni projekat iznosi **600 evra**, dok maksimalni iznos za jedan projekat iznosi **15.000 evra**.

5. Krajnji rok za dostavu predloga je **15 radnih dana** i završava se dana **27.07.2018. godine u 16.00 sati**.

6. NVO mogu da konkurišu sa najviše sa dva (2) projekta u okviru ovog poziva, ali samo sa jednim (1) projektom za svaku od prioritetnih oblasti po pozivu. Period za sprovođenje projekta treba da iznosi najviše **12 meseci**. Ista NVO može da bude partner u nekoliko projekata u prioritetnim oblastima poziva.

Pravo konkurisanja sa svojim projektima imaju nevladine organizacije koje su duže od godinu dana registrovane u registru nevladinih organizacija Republike Kosovo. Nevladine organizacije koje se prijavljuju treba da dokažu da u svom portfoliju imaju aktivnosti za **zaštitu jezičkih prava**. NVO takođe, treba da imaju obavljene finansijske transakcije na

transparentan način na osnovu zakonodavstva za NVO u Republici Kosovo i u skladu sa pravilima računovodstva kao i da su ispunili ugovorne obaveze prema *davaocu finansijske podrške* i svim drugim davaocima javne finansijske podrške.

Posle potpisivanja ugovora, nevladine organizacije treba da dostave dokaze da odgovorna osoba NVO i menadžer projekta nisu pod istragom za krivična dela, kao i dokaze da je NVO rešila sva otvorena pitanja o isplati neplaćenih doprinosa i poreza ukoliko je primenljivo.

7. Predlozi se dostavljaju samo u okviru predviđenog formulara, koji se zajedno sa Uputstvom za podnosiocima zahteva, nalaze na zvaničnoj internet stranici *Kancelarije poverenika za jezike* (www.poverenik-ks.org i <http://kryeministri-ks.net/sr/>)

Kompletna dokumentacija treba da se dostavi poštom ili lično, na dole navedenu adresu:

**KANCELARIJA PREMIJERA/KANCELARIJA POVERENIKA ZA JEZIKE
ZGRADA VLADE
VI SPRAT, 605/A
TRG MAJKE TEREZE B.B.
10 000 PRIŠTINA, KOSOVO**

U „Uputstvu za podnosiocima zahteva“ detaljno je opisan: Proces prihvatanja, otvaranja i razmatranja aplikacija, vrednovanje aplikacija, ugovaranje, resursi, vreme i način podnošenja žalbi, postupanje sa dokumentima i kalendar sprovođenja poziva.

Za finansiranje projekata uzeće se u obzir samo projekti koji su primljeni u roku propisanom ovim javnim pozivom ili koji su poslani poštom pre isteka roka za podnošenje zahteva, i koji u potpunosti ispunjavaju uslove javnog poziva.

8. Sva pitanja u vezi sa javnim pozivom možete razjasniti samo elektronskim putem, slanjem e-maila na adrese: zkgj.kpj@gmail.com i info-zkgj-kpj@rks-gov.net


Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës

Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica


Njoftimi për shprehje të interesit

 Emri i **“Sefedin Smakolli”- Rashan**

 Data: **09.07.2018**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/151 - ESIP/SDG/151-	Blerja e mjeteve te teknologjise informative

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për *përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu **“SEFEDIN SMAKOLLI” Rashan, Mitrovicë**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- **LopTop 4 copë**
- **Projektor 1 copë**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e sukseshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishtëm teknik në adresën e **“SEFEDIN SMAKOLLI” Rashan, Mitrovicë** më së largu deri më **17.07.2018**.

4. Specifikimi i hollësishtëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

5. **Detajet kontaktuese të shkollës:**
6. **Personi kontaktues: Driton Barani**
7. **Telefoni: 049/232-276**
8. **E-maili: driton_barani@hotmail.com**



Nr. ref.1756/18
Datë:06/07/2018

Senati i Universitetit të Shkencave të Aplikuarave në Ferizaj, shpall:
KONKURS
për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor në vitin akademik 2018/2019

Senati i Universitetit të Shkencave të Aplikuarave në Ferizaj në bazë kompetencave të përcaktuara sipas nenit 90 të Statutit të Përkohshëm, në mbledhjen e mbajtur me 04.05.2018 miratojë propozimet e njësisë akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2018/19, ndërsa në mbledhjen e datës 06.07.2018 miratojë kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore bacheloret.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

- Universiteti i Shkencave të Aplikuarave në Ferizaj në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2018/2019, do të regjistrojë 410 studentë të rregullta.
- Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të paraparë si më sipër, Universiteti do të regjistrojë deri në 2% përkatësish deri në 8 studentë të rregullt që i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorëve (anëtarë të familjes së ngushtë të dëshmorëve janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët). Studentët e kësaj kategorie do të shpërndahen në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
- Si shtesë e numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12%, përkatësish deri 49 studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
- Në Universitet, në bazë të kuota të përcaktuara nga MASHT-i, mund të pranohen edhe kandidatët nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvegja deri 3% përkatësish 12 studentë, si dhe 2%, përkatësish 8 studentë nga Maqedonia dhe Shqipëria. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërmënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrihen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
- Përjashtëmësi kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2, 3 dhe 4, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuota të rezervuar.
- Universiteti nuk do të mundësojë lehtësira për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
- Të drejtë pranimi në Universitet kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë në njëren prej shkollave publike apo shkollave private të licencuar në Republikën e Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
- Në Universitet mund të pranohen edhe studentët nga shtetet e tjera, në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
- Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet të verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASHT-it, e cila u dorëzohet të gjitha njësisë akademike.
- Njohja e diplomave për institucionet jashtë Kosovës do të dokumentohet në bazë të nostrifikimit nga organet kompetente.Vendimi për njohjen dhe barasvleren e diplomës merret në MASHT.
- Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaramin.
- Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftosat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
- Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklarim, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
- Kandidatët për pranim si student të USHAF në vitin akademik 2018/19 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një program të studimit.**

II. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

- Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë 48 orë prej publikimit të rezultateve, përkatësisht nga data 20.07-21.07.2018 ora 16:00. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet vetëm nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave.
- Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në Administratën Qendrore të UShAF-it nga data 26.07.2018 deri më 27.07.2018

III. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

- Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:
a) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
- Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.

- Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
- Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe
- Pikët nga lëndët prioritare (3 lëndë) deri në 40 pikë.
Secila dëftesë e shkollës së mesme të lartë vlerësohet mbi bazën e suksesit më së shumti me 5 pikë.

- Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
- Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
- Përjashtëmësi kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të pikës III, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriterëve të përcaktuara si në paragrafin 2, 3 dhe 4 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
- Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
- Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e UShAF.
- Për funksionimin e programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 20 studentëve.
- Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të lëndëve prioritare, e nëse edhe pikët e lëndëve prioritare janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës mesme. Në qoftes se edhe suksesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore.
- Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

IV. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

- Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 09.07.2018 deri më 17.07.2018 në ora 16.00 (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të dielave).
- Ditën e parë të konkursit, me datë 09.07.2018, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora 08.00, ndërsa pranimi i dokumentacionit do të fillojë nga ora 10.00.
- Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:
a) Certifikatën e lindjes (original),
b) Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (original, të noterizuara ose dublikatë),
c)Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose certifikatën të maturës, nëse ka pasur provim të maturës (original, të noterizuar ose dublikat),
d) Kopjen e letërnjoftimit,
e)Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: www.ushaf.net/apliko
f) Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit të Shkencave të Aplikuarave në Ferizaj, ndërsa pagesa bëhet në bankë,
g) Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.
- Me rastin e aplikimit të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në pikën 3 t'i dorëzojnë në Administratën e Universitetit në dosje (faskël) të bardhë, për të gjithë kandidatët duhet të jetë unike.
- Dokumentet në pikën b) dhe c) mund të pranohen duplikat vetëm nëse dëshmohen me vërtetim nga organet kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj. P.s. PAS NXJERRJES SË DOKUMENTEVE DUBLIKAT, DOKUMENTET ORGJINALE NUK MUND TË SHFRYTËZOHEN NGA KANDIDATI PASI QË KY VEPËRIM KONSIDEROHET VEPËR PENAL.
- Njoftimet dhe oraret ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në ueb-faqen e Universitetit. Data e mbajtjes së provimeve pranuese në Universitet do të jetë me 18.07.2018 ora 9.00.
- Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrihen provimit pranues. Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!
- Shpallja e rezultateve të provimit pranues dhe rezultateve preliminare bëhet më së voni, deri më 19.07.2018 ndërsa rezultatet përfundimtare shpallen 23.07.2018 në fakultetet përkatëse si dhe në ueb-faqen e Universitetit.
- Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjafueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo regjistrim nga fakulteti.
- Në programet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkurs plotësues.
- Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen Administratës Qendrore ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.ushaf.net
- Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në Administratën Qendrore të UShAF-it për të gjitha programet me datën 24.07.2018 dhe 25.07.2018:
- Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen 17.09.2018 deri më 18.09.2018. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, dhe i humbet e drejta e regjistrimit dhe vendet e tyre do të plotësohen me kandidatët e ranguar në listë si të pa pranuar duke filluar nga numrat e parë të listës së kandidatëve jashtë pranimit.
-Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përfunduar në momentin e fotografimit.
-Në qoftesë kandidati i pranuar në afatin e caktuar nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit .
- Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
a) Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,
b) Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
c) Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin e Shkencave të Aplikuarave në Ferizaj, vitin e parë të studimeve e kanë falas.
d) Pagesa për një semestër për studentë që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, do të jetë në lartësi prej 25 € për studime të rregullta.
Pagesa bëhet në njëren prej bankave afariste me fletëpagesën, e cila shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit të Shkencave të Aplikuarave në Ferizaj.

I. UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ
Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë 487 studentë në fakultetet si në vijim:

Programi	Për studime të rregullta	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 3%	Kandidatët nga Shqipëria dhe Maqedonia 2%	Gjithsej
Gjithsej	410	8	49	12	8	487
Fakulteti i Arkitekturës,Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit	160	3	19	5	3	190
Programi Arkitekturë i Interierit dhe Dizajni i Mobileve	100	2	12	3	2	119
Programi:Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve të Drurit	60	1	7	2	1	71
Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit	150	3	18	4	3	178
Programi Menaxhment i Turizmit dhe Hotelerisë	150	3	18	4	3	178
Fakulteti i Inxhinierisë me Informatikë	100	2	12	3	2	119
Programi Inxhinieri Industriale me Informatikë	100	2	12	3	2	119

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për ata kandidatë që nuk kanë të kryer maturën mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të programeve të fakultetit dhe atë:

- Në Programin: Arkitekturë e Interierit dhe Dizajni i Mobileve, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë;
- Në Programin: Dizajni dhe konstruksionet e produkteve të drurit, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë;
- Në Programin Menaxhment i Turizmit dhe Hotelerisë, nga lëndët: Ekonomi dhe ndërmarrësi, Matematikë, Informatikë;
- Në Programin: Inxhinieri Industriale me Informatikë, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë.

Për kandidatët me maturë përzgjedhja do të bëhet sipas lëndëve prioritare dhe atë sipas programeve në vijim:

- Menaxhment i Turizmit dhe Hotelerisë
 - Informatikë
 - Matematikë
 - Ekonomi dhe Ndërmarrësi
- Inxhinieri Industriale me Informatikë
 - Matematikë
 - Informatikë
 - Fizikë
- Arkitekturë e Interierit dhe Dizajni i Mobileve
 - Matematikë
 - Informatikë
 - Fizikë
- Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve të Drurit
 - lëndët prioritare
 - Matematikë
 - Informatikë
 - Fizikë



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Nr. I-180/01/18
Junik
Dt.09.07.2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, neni 17, të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, neni 5 pika c,d të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ Procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues numër 08/2014, datë, 25.02.2014, neni 2 pika 1,2,4, dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Statutit të Komunës, Komuna e Junikut shpallë:

K O N K U R S

- Për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës fillore dhe e mesme e ulët **“Edmond Hoxha”** në Junik;
- Për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës në Gjinnazin **“Kuvendi i Junikut”** në Junik,

Kualifikimet, shkathtësitë, aftësitë dhe përvoja:

- ✓ Kërkohej Kualifikimi i arsimit universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitarë), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënëscve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;
- ✓ Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- ✓ Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim.
- ✓ Të ketë së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Të posedojnë këto dokumente;

- Certifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- Dëshminë për përvojën e punës;
- Protofolion profesionale;
- Letër reference nga një institucion publik-kredibil (MASHT, DAKRS, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraparak, institucionet e arsimit të lartë)
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprahe;
- Plani zhvillimor të institucionit edukativo-arsimorë dhe aftësues për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekste me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12)
- Njohuri në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve themelore të
- Microsoft Office (dëshmi nëse ka);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohej gjendja e tij/saj shëndetësore
- Dëshminë se nuk është nën hetime.

Detyrat kyçe:

- Përpunon dhe koordinon lëndët, informatat, organizon ecurinë e punëve, takimeve ditore dhe prezantimeve dhe përpunon dokumentacionin e drejtpërdrejt që ka të bëjë me procesin edukativo-arsimor;
- Kujdeset për komunikim me palët dhe për komunikim elektronik me akterët relevantë;
- Asiston në përgatitjen e dokumentacionit dhe materialeve të nevojshme të kërkuara nga i tërë personeli i shkollës, DAKRS MASHT-it, si dhe për Bordin e shkollës;
- Bën kontrollimin profesional të cilësisë mësimore, organizative në të gjitha nivelet arsimore në bashkëpunim me trupat e tjera të institucionit, DAKRS, MASHT-it;
- Drejtori i shkollës të punojë së bashku me stafin dhe shërbimet tjera që të sigurojë arsim cilësor për të gjithë nxënësit;
- Drejtori i shkollës, së bashku me Bordin e shkollës, këshillin e shkollës DAKRS do të përgatitë dhe menaxhojnë autonominë financiare të shkollës sipas formulës së financimit;
- Të kryen punë dhe detyra tjera që i ngarkohen nga DAKRS dhe MASHT-i në interes për shkollën;
- Koefficienti për drejtor në SHFMU: 7.8
- Koefficienti për drejtor në Gjinnaz : 8.4
- Orari i plotë

Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim;
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen;

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurim) mund ta tërheqin në zyrën e pritjes Komuna e Junikut ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar;

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në gazetën ditore, Për ditën e testit, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes telefonit.

Udhëheqësja e personelit:
Venera Shala

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Arionit Hajrizi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme profesionale Qendra e Kompetencës Skenderaj.

▶ Bekë Beka shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likofc - Skenderaj.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira për një person të huaj, Banesa duhet të jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet të ketë dy dhoma gjumi, të jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770

▶ Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllushi (pas 13 katesh). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift në Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira në Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknikë në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ar, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info: 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel: 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afat të gjatë dhe të shkurtër. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobilave "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

▶ Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërm, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

▶ Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe , një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordnancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe +46705793508.

▶ Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Shefqet Shala, B.I.-Skenderaj. Tel.044-499-713.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333